

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7609 E premte 3 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

**P**ër Teatrin është thënë pothuaj gjithçka; nga tjetërsim i pronës publike tek shkatërrimi i trashëgimisë historike-kulturore, nga shkelje të ligjeve dhe ...  
Vijon në faqen 21

**Teatri dhe ekonomia simbolike**

Nga ANDI TEPELENA



Opinion

Ditës

**N**uk është hera e parë që më është dashur të shkruaj për koncesionet dhe specifikisht për koncesionin e Rinasi dhe gjithë problematikën që janë konstatuar...  
Vijon në faqen 20

**Fundi i një koncesioni dhe fillimi i reagimit institucional**

Nga PROF. ASC. DR. REZANA KONOMI



Familjarët: E vranë sepse mbrojti një vajzë

## Ekzekutohet me dy plumba pas shpine në Bari të Italisë 23-vjeçari shqiptar

Autorët me "Scooter" e qëlluan të riun nga Mirdita në mes të një sheshi të mbipopulluar. Miqtë: Do na mungosh vëlla, ata do e pagujnë!

Një 23-vjeçar shqiptar u ekzekutua mbrëmjen e së mërkurës në Bari të Italisë. Sipas "ANSA"-s, viktima është Viktor Picaku i padënuar me parë. Ngjarja e rëndë ku mbeti i vranë i ri shqiptar ndodhi rreth orës 21:35 në sheshin "Abbazia" të Coratos, (provincë e Barit), në praninë e dhjetëra personave që kishin mbushur...

Në faqen 8

## MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DO TE BLEJE TOKE NE QENDER TE KRYEQYTETIT

# SHPRONESIMET NE TIRANE, 200 MLN LEKE PRONAREVE

Publikohet lista e plotë e pronave që preken dhe vlera për secilin përfitues. Ministria: Do t'i përdorim për rikualifikimin e sheshit



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqen 6

KESHILLI I MINISTRAVE

**Kosovë-Shqipëri, në janar hiqet kufiri. Majko përplaslet me Gjuriç për vendimin**

Në faqen 3

DETAJET E NGJARJES

**Vetëvritet gruaja e gjyqtarit Hallunaj, fqinjët: Nuk pamë njerëz të dyshimtë**

Në faqen 7

INTERVISTA

**Mostafa Mohammadi: Shqiptarë, më ndihmoni të liroj vajzën time, peng i organizatës MEK**

Në faqen 9

LISTA E PLOTE

**Lista me 710 personat që kanë gati lejet e legalizimeve, në Tiranë dhe Lushnjë**

Në faqen 18-19

KESHILLAT POPULLORE



**Merja: Si të veproni për të parandaluar atakun dhe kura për zemër të shëndetshme**

Në faqen 10

Vendimi i këshillit/ Do përzgjidhen 16 fitues, sa do të shpërblehen

## Intership 3-mujor në Bashkinë e Tiranës, si aplikohet

Zbardhet formulari, 4 fazat e projektit dhe data e fundit e kandidimit

Nga VOLTIZA DURO

**T**ë gjithë ata të rinj deri në 28 vjeç që kanë përfunduar studimet e larta në ciklin e parë apo të dytë, mund të aplikojnë për të fituar një intership 3-mujor në Bashkinë e Tiranës. Deri në datën 7 gusht të këtij viti,



të interesuarit do të kenë mundësinë të aplikojnë me një koncept për projekt ose studim sipas temave të përcaktuara. Nëpërmjet konkurimit, do të përzgjidhen 16 fituesit me idetë më të mira, të cilët më tej do të punojnë nga afër me stafin...

Në faqen 11

# KUFIRI KOSOVE-SERBI REAGIMET



## SHBA DO DËRGOJË MBI 100 USHTARË NË KOSOVË

Mbi 125 ushtarë të batalionit për sulme helikopterë të Gardës Kombëtare të shtetit amerikan Tenesi, vitin e ardhshëm do të dërgohen në Kosovë. Ata do të shërbejnë në Kosovë për 11 muaj dhe do t'i ofrojnë ndihmë KFOR-it në ruajtjen e paqes. "Stabilizimi i këtij vendi është një angazhim i SHBA-ve dhe NATO-s, prandaj Garda Kombëtare e Tenezisë ka vendosur njësi të shumta dhe personal gjatë viteve të fundit, për të ndihmuar në ruajtjen e paqes", ka thënë tutje gjenerali Hatson.



## OPOZITA, KUNDËR PROPOZIMIT TË THAÇIT

Deklarata e Presidentit Thaçi për mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për korrigjim të kufijve me Serbinë ngjalli reagimin e ashpër partive politike në Kosovë. Shpend Ahmeti dhe Visar Ymeri nga PSD kërkuan mbledhjen e menjëhershme të Kuvendit të Kosovës. Për kreun e grupit parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, lojërat e fjalëve si "shkëmbim terriroresh" dhe "korrigjim i kufijve" e dëmtojnë Kosovën. "Lojërat me fjalë si 'shkëmbim terriroresh' dhe 'korrigjim të kufijve' janë të kota, por po na kushtojnë me stopim të plotë të njohjeve të reja".



## VUÇIÇ LIDHUR ME DIALOGUN

"Të nxjerrim sa më tepër që mundemi, e të humbim më pak se që jemi të detyruar, kjo është ajo për të çfarë, në kushte gati të pamundura, po luftojmë kur bëhet fjalë për Kosovën", ka thënë sot Vuçiç, duke shprehur bindjen se nuk do të fitojnë më pak se ajo çfarë iu është ofruar. E shihni çfarë është duke bërë Britania e Madhe nëpërmes agjenturave të saj në Serbi, Kosovë dhe Maqedoni. Ne po luftojmë në kushte shumë të vështira, gati të pamundura të nxjerrim sa më shumë që mundemi për popullin tonë, e të humbasim sa më pak", ka thënë ai.



Gjatë një mbledhjeje të përbashkët të të dyja qeverive

Presidenti kosovar: Nëse arrihet marrëveshja, marrim Luginën e Preshevës

Pamela Aliaj

Ndërkohë që pas deklaratës së bërë para dy ditësh ku Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, qetësoi qytetarët lidhur me dialogun me Serbinë për mosndarje të Kosovës, ditën e djeshme ai foli sërish për mundësinë, siç e cilësoi ai, të korrigjimit të kufirit me Serbinë gjatë procesit të ardhshëm të dialogut. Këto komente Thaçi i bëri pas vizitës në Odën Ekonomike të Kosovës. Ai tha se përfaqësuesit e komunave Preshevë, Bujanoc e Medvegjë e kanë shprehur vullnetin e tyre që Luginë e Preshevës t'i bashkohet Kosovës, ndaj sipas tij, nëse ka pajtueshmëri në dialog, kjo pjesë do të mund t'i bashkohet Kosovës. "Kemi rreth 400 kilometra të kufirit me Serbinë që duhet të shënjohehen dhe pa demarkacionin me Serbinë, nuk mund të përmbyllet procesi i shtetformimit dhe konsolidimit", tha Thaçi. "Për këtë arsye do të diskutohet për demarkacionin, për korrigjimin e kufijve dhe në kuadër të korrigjimit të kufijve, në asnjë rrethanë, për asnjë çmim nuk do të mund të imponohet realizimi i aspiratës serbe për ndarje të Kosovës. Ndërkaq, mendoj se është shumë e realizueshme, e pranueshme nga ana jonë, kërkesa e institucionali-zuar e përfaqësuesve të Luginës së Preshevës për t'u bashkuar me Kosovën", theksoi presidenti Thaçi. "Nëse ka marrëveshje apo pajtueshmëri të dyanshme (në dialogun me Serbinë) askush nuk do të dilte kundër një marrëveshjeje të dyanshme, pra as nga Bash-

# Dialogu me Serbinë, sqaron Thaçi: Jo ndarje të Kosovës, por korrigjim të kufijve

Marrëveshja për territorin, në fillim vjeshte priten rezultatet



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

## DEKLARATA E THAÇIT

"Kemi rreth 400 kilometra të kufirit me Serbinë që duhet të shënjohehen dhe pa demarkacionin me Serbinë, nuk mund të përmbyllet procesi i shtetformimit dhe konsolidimit. Për këtë arsye do të diskutohet për demarkacionin, për korrigjimin e kufijve dhe në kuadër të korrigjimit të kufijve, në asnjë rrethanë, për asnjë çmim nuk do të mund të imponohet realizimi i aspiratës serbe për ndarje të Kosovës", theksoi presidenti Thaçi.

dhe fillimi i shtatorit dialogu të përparojë nën lehtësimin e Bashkimit Evropian dhe me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## DEKLARATA E THAÇIT DJE

"Si president i vendit edhe njëherë i siguroj qytetarët e Kosovës se nuk do të ketë forcë që do ta detyroj Kosovën të diskutojë, e lëre më të pajtohet me ndarjen e saj. Nuk do të lejojmë as të diskutohet, jo më që dikush të pajtohet me ndarjen e Kosovës. Kjo marrëveshje për Kosovën nënkupton njohje reciproke", u shpreh presidenti Thaçi.

## Mbi 110 vende e kanë njohur, dialogu për kufijtë i papërfunduar

# Avdullah Hoti: Deklaratat për shkëmbim apo korrigjim kufijsh po e dëmtojnë Kosovën

Avdullah Hoti, shefi i Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, tha se lojërat me fjalë si "shkëmbim terriroresh" dhe "korrigjim kufijsh" po i kushtojnë Kosovës dhe po e dëmtojnë shtetin në arenën ndërkombëtare. Hoti tha se me këtë territor që ka aktualisht Kosova dhe me këta kufij, mbi 110 vende e kanë njohur atë. Deklaratat e Hotit vijnë si kundërpërgjigje ndaj disa komenteve të bëra nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili të mërkurën në një intervistë të dhënë për AP-në ka mohuar ndarjen e Kosovës, por e ka lënë si mundësi të hapur "korrigjimin e kufijve". "Askush nuk ka të drejtë të diskutojë për territorin e Kosovës, sepse do të



## DEKLARATA

"Askush nuk ka të drejtë të diskutojë për territorin e Kosovës, sepse do të binte ndesh me vullnetin e popullit të Kosovës për shtet të pavarur, të shpallur me Deklaratën e Pavarësisë, më 17 shkurt 2008 dhe me Kushtetutën e Kosovës", tha Hoti në një postim në "Facebook".

binde ndesh me vullnetin e popullit të Kosovës për shtet të pavarur, të shpallur me Deklaratën e Pavarësisë, më 17 shkurt 2008 dhe me Kushtetutën e Kosovës", tha Hoti në një postim në "Facebook". Sipas tij, vetë ideja që çështja e shkëmbimit të terriroveve apo e korrigjimit të kufijve mund të diskutohet në dialo-



Reagon përfaqësuesi serb, Gjuriç: S'do ketë Shqipëri të madhe

# Hiqet kufiri Kosovë-Shqipëri në janar 2019, Majko njofton vendimin e qeverive

Përgjigja e ministrit: Ëndrrat me ndryshim kufijsh mbaruan

Darina Tanushi

**N**ga 1 janari 2019 nuk do të ketë kufi me Kosovën. Deklaratën e ka bërë ministri i Diasporës i Shqipërisë, Pandeli Majko, gjatë një vizite që ka zhvilluar në Skënderaj të Kosovës, në një manifestim kushtuar mërgimtarëve. Majko theksoi se kryeministri shqiptar, Edi Rama e ka marrë vendimin në fjalë dhe nga 1 janari nuk do të ketë kufi mes dy shteteve. "Duhet me hap kufirin midis Shqipërisë dhe Kosovës, kryeministri na tha që e ka marrë vendimin, më datën 1 janar fillon lëvizja e lirë midis Shqipërisë dhe Kosovës", tha Majko sipas gazetës "Express". Edhe pse në manifestim ishin të pranishëm kryeministri Ramush Haradinaj e presidenti Hashim Thaçi, asnjëri nga ta nuk foli rreth vendimit të Edi Ramës për heqjen e kufirit. Lajmi i dhënë nga Majko i gëzoi fort kosovarët. Pas kësaj deklarate, mbrëmë në Skënderaj shpërthyer brohoritjet dhe duartkujtjet. Vetë Majko e sqaroi këtë deklaratë përmes një postimi në "Facebook", pasi pa reagim që solli ajo çfarë ai kishte thënë më herët. "Dje, (pardje) në një vizitë zyrtare në Prishtinë, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj më konfirmoi lajmin i cili është diskutuar prej kohësh midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës. Ai është fillimi i lëvizjes së lirë së njëzëve dhe mallrave midis dy vendeve tona duke filluar nga 1 janari 2019", shkroi Majko. "Kujtoj se në takimin e parë zyrtar të dy kryeministrave, të Shqipërisë dhe Kosovës, si afat u vendos që ky proces të fillonte në 1 janar 2018. Për arsye të mirëkuptueshme, Qeveria e Kosovës kërkoi kohën e nevojshme për të marrë vendimin. Dje, kryeministri Haradinaj më kërkoi që në festimet ku ishim të ftuar bashkë me Presidentin Hashim Thaçi dhe zëvendëskryeministrat Pacoll dhe Gashi në Komunën Skënderaj, nën hijen e bustit të Bacës Adem Jashari, të isha unë që do të jepja lajmin se Kosova e ka marrë vendimin përfundimtar për lëvizjen e lirë midis kufijve shtetërorë të dy vendeve tona", sqaroi



Ministri i Diasporës i Shqipërisë, Pandeli Majko, gjatë vizitës në Skënderaj të Kosovës

**PËRGJIGJA E MINISTRI**

"Uroj që dikush t'i thotë se Jugosllavia nuk ekziston më... Ëndrrat me ndryshim kufijsh kanë mbaruar përfundimisht. Kosova është shtet i pavarur dhe kjo është arsyeja pse edhe ai është sot drejtor... Natyrisht", u shpreh Majko, në përgjigje të drejtorit të Zyrës Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriç.

**Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë i përgjigjet Majkos**

## Marko Gjuriç: Enver Hoxha ka vdekur, ekziston vetëm kufiri Shqipëri-Serbi

**P**as deklaratave të ministrit për Diasporën për kufirin Shqipëri-Kosovë ka ardhur reagimi nga Beogradi. Drejtori i Zyrës Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriç, ka thënë të enjten se deklarata e ministrit shqiptar të Diasporës, Pandeli Majko se nga 1 janari i viti 2019 se do të hapen kufijtë ndërmjet Shqipërisë e Kosovës është joserioze, e papërgjegjshme dhe se shërben vetëm për shtim të përkeqësimit të marrëdhënieve në rajon. "Enver Hoxha ka vdekur e nga Shqipëria e Madhe nuk ka dhe nuk do të ketë asgjë. Kosova dhe Shqipëria nuk kanë kufij, ekziston vetëm kufiri



ndërmjet Serbisë e Shqipërisë me gjatësi 111 kilometra", citon Tanjug të ketë thënë Gjuriç. Sipas tij, kufiri ndërmjet Serbisë e Shqipërisë shtrihet nga tre kufijshi Maqedoni - Shqipëri

- Serbi deri të tre kufijshi Serbi-Mali i Zi - Shqipëri dhe ky kufi, thotë ai është i vetmi që ka ekzistuar dhe që mund të ekzistojë. "Sipas Rezolutës 1244, në jemi ata që kemi të drejtë t'i shfrytëzojmë kalimet kufitare të Qafa e Prushit dhe në Vërmicë dhe atje kemi personelin tonë. Por për këtë askush në bashkësinë ndërkombëtare nuk shqetësohet e nuk shqetësohet e nuk deklarata të tilla kërcënuese, që çdo ditë vijin nga përfaqësues të ndryshëm", ka thënë para përfaqësuesve më të lartë të Kosovës, Hashim Thaçi e Ramush Haradinaj.

të sot drejtor... Natyrisht", u shpreh Majko. Drejtori i Zyrës Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriç ka thënë të enjten se deklarata e ministrit shqiptar të Diasporës Pandeli Majko se nga 1 janari i viti 2019 se do të hapen kufijtë ndërmjet Shqipërisë e Kosovës është joserioze, e papërgjegjshme dhe se shërben vetëm për shtim të përkeqësimit të marrëdhënieve në rajon. Ka qenë ish-kryetari i Komunës së Skenderajt, Sami Lushaku, që ka shtuar një darkë për nder të së kalu-

arës ku merrnin pjesë presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, ministri shqiptar i Diasporës, Pandeli Majko si dhe politikanë të tjerë të Kosovës. Lushtaku përmes rrjetit social "Facebook" ka thënë se ka pasur një 'takim për qejf' siç e quan ai, me Thaçin, Majkon, Lladrovcin dhe disa miq të tjerë. Në 'sofren' e shtuar nga Lushtaku nuk kanë munguar rakia dhe birra, e sipas tij ky takim u bë për të kujtuar të kaluarën dhe për të vazhduar rrugën e zhvillimit të Kosovës dhe Shqipërisë.

## Zyrtarizohet mësimi shqip në diasporë, Meta dekreton ligjin, si do regjistrohen mësuesit

**Z**yrtarizohet mësimi shqip në diasporë. Presidenti i Shqipërisë, z. Ilir Meta dekretoi ligjin nr. 48/2018, "Për dësa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", ku janë përfshirë propozimet e parashtruara në Strategjinë e re për Diasporën. Mbi bazë të këtij ligji të rëndësishëm, ministria përgjegjëse për arsimin do të krijojë regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqiptare jashtë vendit dhe do të pajisë me certifikatë nxënësit pas përfundimit të programit. Kriteret për krijimin e regjistrit shtetëror dhe dhënien e certifikatës miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin. Gjithashtu, një tjetër shtesë e rëndësishme është përfshirja e përfaqësuesit të ministrisë përgjegjëse për Diasporën në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.



## Negociatat me BE, njësi të integritit evropian në të 61 bashkitë e vendit

**Q**everia shqiptare vendosi pak ditë më parë që të krijohen strukturat e integritit evropian në çdo bashki, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, brenda strukturave të tyre administrative ekzistuese, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Përgjegjësitë e strukturës së integritit evropian që krijohet në bashki do të jenë bashkërendimi dhe mbështetja e strukturave administrative të bashkisë për zbatimin e politikave, të legjislacionit, të investimeve dhe të shërbimeve të lidhura apo që rrjedhin nga procesi i integritit evropian, në nivel vendor. Po ashtu, këto struktura do të bashkërendojnë punën dhe përfaqësimin e bashkisë në marrëdhënien me strukturat e qeverisjes qendrore përgjegjëse për integrimin evropian dhe proceset përbërëse të tij. Këto njësi do të jenë përgjegjëse edhe për rritjen e kapacitetit përthithës të përdorimit të asistencës së Bashkimit Evropian për procesin e integritit evropian në nivel vendor.

Zbardhen diskutimet në Komisionin e Ligjeve për hekurudhën Tiranë-Durrës

# Doshi, kritika qeverisë: Bëtë hekurudhën por na duhen trenat, mos lini pas veriun

"Ju nuk keni siguruar akoma lekët, apo do kërkon borxh në Ballkan"

Brenda vitit 2020, qeveria mendon të ndërtojë hekurudhën Tiranë-Durrës dhe Tiranë-Rinas që do të ketë një kapacitet prej 700 mijë pasagjerë në vit. Pak ditë më parë, në Komisionin parlamentar të Ligjeve u bë një diskutim mjaft i gjatë për këtë çështje, ku ishte i ftuar zv.ministri i Infrastrukturrës, Artan Shkreli. Deputeti Tom Doshi pati kritika për qeverinë sa i përket mungesës së vëmendjes për veriun e vendit. "GSH" sjell sot të zbardhur diskutimin në Komisionin e Ligjeve.

Edmond Leka - Faleminderit! Qëllimi i këtij projekti është ratifikimi i marrëveshjes së grantit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për hekurudhat shqiptare. Kjo marrëveshje synon zbatimin e projektit të detajuar për rehabilitimin e hekurudhës Tiranë-Durrës dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore me aeroportin e Rinasit, hartuar në bazë të marrëveshjes së grantit në datën 13 mars 2015, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe BERZH-it, si administrator i fondeve grant të siguruar nga qeveri të ndryshme nën fondin e përbashkët evropian të Ballkanit Perëndimor.

Objektivat kryesorë në drejtim të rezultateve lidhen me rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore nga stacioni qendror hekurudhor i Durrësit deri në vendndodhjen e ardhshme të terminalit të transportit publik të Tiranës, një gjatësi rreth 34 kilometra dhe gjithashtu, për të ndërtuar një linjë të re hekurudhore, që lidh linjën kryesore ma aeroportin e Rinasit, një gjatësi rreth 4,7 kilometra. Projekti parashikohet të përfundojë më 31 dhjetor të vitit 2020, granti në shumën 35 milionë e 435 mijë euro do të akordohet nga BERZH-i dhe do të përdoret për financimin e punimeve për rehabilitimin e linjës ekzistuese, ndërtimin e linjës së re, shërbimin e mbikëqyrjes, mbikëqyrjen e punimeve, si dhe mbështetjen për zbatimin e projektit. Tom Doshi - Në rregull, hekurudhën po e ndërtojmë, po për trenat a është parashikuar të blihen të rinj? Sepse, në fakt, nuk kemi trenat.

Artan Shkreli - Sa u përket trenave, është një fazë e dytë, për të cilën kemi filluar punën dhe do ta zhvillojmë më tej. Investimi për blerjen e mjeteve lëvizëse nuk mund të futej në këtë paketë, kështu që do të shfrytëzohen paketa të tjera. Sigurisht, do të vendosen trenat të rinj të tipit modern, ata që quhen njësi multifunktionale vetëlëvizëse. Kështu që kur të mbarojë pjesa e ndërtimit të hekurudhës, e cila do të zgjasë rreth 3 vjet gjatë kësaj kohe, do të punohet edhe për blerjen e këtyre mjeteve lëvizëse, lokomotiva dhe vagonet.

Tom Doshi - Kam një pyetje për zëvendësministrin. Thate që do të jetë shumë i rëndësishëm stacioni që lidh Malin e Zi dhe Shqipërinë, por hekurudha Han i Hotit-Tiranë si është parashikuar? Artan Shkreli - Në këtë moment jemi duke bërë projektin e detajuar, pra fizibiliteti është miratuar, gjithashtu jemi në fazat e fundit të këtij projekti prej 4,5 milionë eurosh. Bëhet fjalë për një grant, i cili i hap rrugë rehabilitimit të hekurudhës së Hanit të Hotit. Ne shpresojmë që brenda vitit të ardhshëm të kemi siguruar financimin për fillimin e punimeve të rehabilitimit të kësaj linje kaq të rëndësishme. Ndërkohë, po merremi me përfundimin e fizibilitetit të hekurudhës Pogracec-Lin-Mal i Zi.

Tom Doshi - Hekurudha nuk është siç janë rrugët, që bëhen me akse, pra nëse bëhet fjalë që të bëhet rehabilitimi i rrjetit hekurudhor, ai duhet të bëhet të paktën nga Hani i Hotit deri në Tiranë. Nuk mund të bëhen akse të tilla. Këta sot kanë ardhur të papërgatitur për të gjithë rrjetin hekurudhor shqiptar. Këta kanë ardhur vetëm për një marrëveshje... Ulsi Manja - Këta kanë ardhur për një marrëveshje për linjën Tiranë-Durrës.

Tom Doshi - Ju e kemi shumë merak linjën Tiranë-Durrës. Faktikisht, këtu është qendra më e madhe e banimit, por nuk duhet lënë pas dore dhe Veriun. E mira është, që ju të bëni një studim për të gjithë rrjetin hekurudhor shqiptar.

Thimio Plaku - Desha të sqaroj, se kemi një studim të plotë për të gjithë rrjetin hekurudhor shqiptar, ku siç ju thashë, linja hekurudhore ndërkombëtare me Malin e Zi, do të fillojë menjëherë mbas linjës Tiranë-Durrës. Presim vetëm që projekti të maturohet në kuptimin e hartimit të projektit të detajuar dhe të vlerësimit ambiental. Më pas me këtë projekt do të shkojmë në samitet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ku do të aplikojmë për grant për gjysmën e financimit (në mënyrë shumë të ngjashme me këtë projekt), për reha-

bilitimin e kësaj linje hekurudhore. Ulsi Manja - Është normale të fillojë nga Hani i Hotit, sepse ajo është e vetmja portë hyrëse dhe lidhëse jona me rrjet hekurudhor me Malin e Zi dhe me Europën, sepse nga Hani i Hotit lidhemi me hekurudhë me Europën dhe më pas kur vjen poshtë, nuk ka më na lidh, vetëm, sipas studimit të projektit të ri lidhja me Maqedoninë. Ju lutem, zoti Doshi!

Tom Doshi - Kam edhe një ndërhyrje. Sipas specialistit që ka ardhur këtu të prezantojë projektin, thuhet se mbasi të bëjmë studimin dhe projektin, do të dalim të



Komisioni i Ligjeve

lypim lekë borxh. Dome thënë, qeveria nuk ka fonde për këtë punë, megjithëse Ulsiut i intereson politikisht të thotë se është bërë një punë e madhe, por ju nuk paskeni siguruar akoma lekët për investimin. Mbasi ti kryeni këto punë, do të drejtoheni nëpër Ballkan për të kërkuar lekë borxh?

Ulsi Manja - Jo në Ballkan, se Ballkani nuk ka lekë për vete. Ka Europa lekë sa të duash. Mjafton të kemi projekte të mira dhe konkurrese, si ky që kemi sot mbi tryezë. Shqipëria ka mjaftueshëm kapacitete për të bërë projekte. Po të kishte lekë Ballkani, do të kishte bërë me kohë hekurudhat dhe punët e tjera.

Artan Shkreli - Gjithsesi, bëhet fjalë për një shifer relativisht të lartë për xhepat e buxhetit të shtetit. 170 milionë euro është shuma për rehabilitimin e hekurudhës deri në Han të Hotit, i cili mendohet ashtu si ky projekt, që gjysmën ta ketë grant dhe gjysmën ta ketë hua. Gjysma e shumës 170 milionë euro grant është realisht një shifer për të cilën ia vlen të dalim me trashë nëpër Europë. Është një gjë, që kemi shumë besim se do ta fitojmë, sepse edhe Europa është e interesuar në këtë rast. Bëhet fjalë për një lidhje me të dhe nuk bëhet fjalë për një rrjet të brendshëm hekurudhor, sikurse është linja Tiranë-Durrës, për të cilin natyrisht, interesi i tyre është më i ulët.



**Dekrete për lojërat e fatit, Vasili: I drejtë, jo lehtësira fiskale bixhozit**

Deputeti i LSI, Petrit Vasili, e cilësoi të drejtë vendimin e Presidentit Meta, i cili me anë të një dekreti, riktheu për rivotim në Kuvend ligjin për "Tatimin mbi të ardhurat", duke shprehur rezervat për nën 6 që trajton tatimin e lojërave të fatit. Në rubrikën "Opinion" në "News 24", kreu i grupit parlamentar të LSI tha se me këtë vendim synohet që të rishikohet ligji, në mënyrë që të mos i krijohen lehtësira fiskale bixhozit. "Është një vendim shumë i drejtë i presidentit. Unë nuk kam pse bëj më shumë komente. Bëhet fjalë për një masë inkurajuese dhe jo dekurajuese që vjen sot me këtë ligj, pasi nuk duhet të ketë lehtësira fiskale për bixhozin. Dua të rikujtoj se në 2013-ën ka pasur një operacion të policisë, "Fundi i Marrësisë", në atë kohë Rama tha se askush nuk do ndalonte këtë aksion, derisa asnjë shqiptar të mos lërë asnjë qindarkë në kumar. Por shifrat aktuale flasin tjetër gjë", u shpreh Vasili. Ndryshimet e ligjit për "Tatimin mbi lojërat e fatit" u miratuan në muajin Korrik me paketën e re fiskale, ku tatimi mbi të ardhurat 15% nuk do të llogaritet mbi xhiron, por mbi të ardhurat bruto, duke zbritur shumën që ju shpërndahet lojtarëve fitues. Ndryshimi i fundit ligjor që është rikthyer për rishikim nga Presidenti Meta u interpretua nga Financa si një saktësim për të harmonizuar atë me ligjin bazë të lojërave të fatit që u miratua në vitin 2015.

## Deputetja e PD-së: Qeveria favorizon Lotarinë Kombëtare

### Kadiu: PD, e vendosur të shfuqizojë çdo ligj që ul taksat për biznesin e bixhozit



isë, me pretendimin se do të mbyllte kazinot dhe biznesin e bixhozit nëpër të gjitha cepat e pallateve. Ky operacion përfundoi të ishte vetëm një marrëzi e pafund. Pikat e basteve janë katërfishuar, sepse qeveria e Edi Ramës ka vendosur të zgjerojë biznesin, me të cilin iu mburr shqiptarëve se do ta mbyllte. Në 2013-ën ato ishin 928, sot numri i tyre e kalon 4230 pika baste, bixhozi dhe kazinosh. Vetëm në vitin 2017, shqiptarët kanë lënë 132 milionë euro në bixhoz. Është e vërteta që Ministria e Financave, tinëzish, po kërkon të mbulojë, duke

kanalizuar aferën korruptive të lojërave të fatit në një diskutim teknik, pa u thënë shqiptarëve pse e shtyn zbatimin e ligjit prej 3 vjetësh. E vërteta është se ndryshimet ligjore favorizojnë Lotarinë Kombëtare, kompani e cila do të përfitojë nga lehtësitë në taksim, njësoj siç përfitojnë bizneset e tjera të bixhozi që nga viti 2015", tha ajo. Më tej, deputetja demokratike tha se biznesi po dëmtohet jo vetëm nga skema e TVSH, por edhe rritja e çmimit të ujit dhe energjisë elektrike.

Partia Demokratike është e vendosur të shfuqizojë çdo ligj që ul taksat për biznesin e bixhozit. Këtë e ka deklaruar dje deputetja demokratike, Fatbardha Kadiu në një deklaratë për mediat. Ajo u shpreh: "Ministria e Financave duhet t'u thotë shqiptarëve pse biznesi i bixhozit është katërfishuar gjatë qeverisë së Edi Ramës, pse ka lehtësuar nga taksat biznesin e kontrolluar prej vëllait të kryeministrit, pse shtyn prej 3 vjetësh zbatimin e ligjit për mbylljen e lojërave të fatit". Kadiu është ndalur edhe tek operacioni "Fundi i Marrësisë", duke hedhur akuza mbi qeverinë Rama. "Pusheteti i Ramës nisi me reklamën e madhe të operacionit 'Fundi i Marrë-

Sektori i shërbimeve është kontribuuesi kryesor në arkën e sigurimeve shoqërore shëndetësore, pasi siguron gati gjysmën e fondeve të arkëtuara në buxhetin e shtetit, sipas përllogaritjeve të Ministrisë së Financave për vitin 2017. Mirëpo, teksa bujqësia punëson mbi 40 për qind të totalit të punësuarve, ka kontribut thuajse zero. Në vend të dytë për nga rëndësia në derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore vjen sektori i tregtisë, i cili

**Statistikat për të ardhurat në skemë, bujqësia punëson 40%, por paguan zero**

**Skema e pensioneve, gjysma e kontributeve paguhet nga shërbimet**

paguan 21 për qind të totalit, më pas vjen sektori i prodhimit me 18 për qind, ndërtimi me 7 për qind të totalit dhe transporti me vetëm 3%. Në vitin 2017 në krahasim me 2016 derdha e kontributeve nga sektori i shërbimeve është rritur me 5%, sektori i prodhimit është

rritur me 9%, sektori ndërtimit është rritur me 5%, sektori i tregtisë 7% dhe sektori i transportit është rritur me 3%. Peshën më të madhe për numër mesatar kontribuuesish e zë biznesi i madh dhe ndërmarrjet shtetërore buxhetore, përkatesisht 51% dhe 22%. Në sek-

torin shtetëror vihet re një rritje e këtij treguesi me 2%. Ndërsa në sektorin privat, ky tregues ka shënuar rritje dhe konkretisht 7% në biznesin e madh, 18% në biznesin e vogël me TVSH dhe 8% në biznesin e vogël pa TVSH. Vitin e kaluar u grumbulluan rreth 86 miliardë lekë



kontribute në formën e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore. Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur rreth 74 miliardë lekë, 7.3 miliardë lekë, ose 11% më shumë sesa 2016 dhe nga sigurimet shëndetësore janë

mbledhur 11.6 miliardë lekë, 1 miliard ose 7% më shumë se 2016. Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 12-mujore rezultoi se në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve krahasuar me mesataren e 2016. Numri i kontribuuesve për muajin dhjetor 2017 është rritur me afërsisht 37 mijë kontribuues ose 6.2%, krahasuar me 2016. Megjithatë, Shqipëria vijon të ketë rendimentin më të ulët fiskal në rajon në drejtim të kontributeve.

**Kontrulli i Lartë i Shtetit zbardh abuzimet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive në Fier**

Ornela Manjani

Kontrulli i Lartë i Shtetit ka kallëzuar në prokurori 12 punonjës të hipotekës në Fier, pasi akuzohen për disa shkelje gjatë detyrës së tyre. Bëhet fjalë për tre ish-regjistruer, tre përgjegjës sektori dhe specialistë të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Këta persona nga auditimi i kryer prej këtij institucioni rezultojnë të kenë kryer regjistrime të pasurive pa dokumentacionin e duhur ligjor, me dokumente të parregullta për sipërfaqen prej 580392 m<sup>2</sup>, ndryshime zëri kadastral nga pus naftë, zallishite, rrugë, përranjë në truall për sipërfaqe 28360 m<sup>2</sup>, regjistrim pasurive shtetërore (të privatizuara) pa arkëtuar qira trualli me dem ekonomik në vlerën 1,900 mijë lekë, pa dokumentacionin ligjor, moskufizime prona të paligjshme me vendim gjykatës për sipërfaqe 108569 m<sup>2</sup> si dhe kanë shmanjur procedurat ligjore duke regjistruar legalizime mbi prona shtetërore (ndërtesa) për arkëtimin e vlerës 120 milionë lekë, si dhe vlerën 11,5 milionë lekë të ardhura të munguara për buxhetin nga mospagesa e taksës së regjistrimit për ambientet e përbashkëta. KLSH i ka kërkuar kryerregjistruerit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të vlerësojë shkallën e përgjegjë-

**KLSH kallëzon në prokurori 12 punonjës të hipotekës**

*Shpërdoruan detyrën, shpërndanë tokë në kundërshtim me ligjin*



sisë dhe marrjen e masave disiplinore për 12 punonjës, të cilët në mospërbushje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave ligjore, kanë konsumuar elementët e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës". KLSH përmes njoftimit për media bën me dije se i ka përcjellë me shkresë indicie për kallëzim penal Prokuror-

isë së Rrethit Gjyqësor Fier, të gjitha provat dhe dokumentet e përkatëse.

**RAPORTI**

Në raport mësohet se në 7 raste janë regjistruar pasuri për 2100 m<sup>2</sup> truall dhe 859 m<sup>2</sup> ndërtim. Për këto regjistrime nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përbajtjes së aktit administrativ i Lista e ish-pronarëve të trojeve dhe

**REGJISTRIMET**

Punonjësit kanë regjistruar pasuritë e paluajtshme sipas AMTP-ve, të cilat rezultojnë të korrigjuara, duke shtuar parcela për sipërfaqen takuese, duke përfutur më tepër 217803 m<sup>2</sup>, në favor të poseduesve të AMTP-ve.

shtëpive" dhe dokumentacioni është i parregullt e fotokopje. Në 11 raste nuk kanë marrë asnjë masë për regjistrimin e vendimeve të gjykatave, që kanë vendosur shfuqizimin e AMTP-ve dhe kthimin në pronësi "shtet", duke mos regjistruar në pronësi "shtet" sipërfaqen totale 69463 m<sup>2</sup>, por që nuk figurojnë të regjistruar në regjistrat e ZVRPP dhe nuk evidentohej gjendja juridike e pasurive. Kanë

kryer transaksione për pasuritë regjistruara në (KPP), duke kryer transaksione fiktive për përfitim të një sipërfaqe prej 10 000 m<sup>2</sup>. Këto shërbime i janë ofruar subjektit në kushtet kur përfutuesi i AMTP-së nuk rezultoi të ketë qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore, duke përfutuar padrejtësisht një sipërfaqe prej 10000 m<sup>2</sup>. Nuk ka verifikuar elementet e formës dhe të përbajtjes së Vendimeve

të gjykatës dhe nuk është vepruar për regjistrimin e pasurive shtet, pa vendosur kufizimet përkatëse për AMTP pa numër dhe datë, në 2 raste për sipërfaqen 24100 m<sup>2</sup>. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të papërfunduara, të cilat prej 4 vitesh deri në 30.06.2017, arrijnë në rreth mbi 19235 praktika me të ardhura të përfutur pa dhënë shërbimin e faturuar; mosadministrimin në arkiv të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata. Në 12 raste ka regjistruar pasuri të paluajtshme për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, mbi normën për frymë të çdo fshati, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre kanë përfutur më tepër në total tokë me sipërfaqe 73 070 m<sup>2</sup>, se sipërfaqja takuese e ndarë sipas normës për frymë. Në 20 raste me sipërfaqe totale 13734m<sup>2</sup> kanë regjistruar pasuri në favor të poseduesve të AMTP-ve, ndërkohe që në KPP dhe regjistrat përkatës figuron e llojit "hekurudhë", "rrugë" dhe "përrua", pasi pasuritë e regjistruara nuk janë të llojit "tokë bujqësore" apo truall", - thuhet në njoftimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**Bllokohet edhe një makinë me 72 kg mjaltë**

**AKU sekuestron në Kapshticë pesticide të padeklaruar, të ardhura nga Greqia**

**KORÇË** - AKU vijon aksionin e saj në terren, ndërsa dje ka sekuestruar disa produkte të pasigurta që kishin ardhur nga Greqia. Inspektorët e DRAKU, Korçë në bashkëpunim me doganën e Kapshticës kanë konstatuar se shtetasi Petro Kyçyku me makinën e tij tip "Seat Ibiza", me targë "NEB 3653" kishte sasi të konsiderueshme prej afro 141 kg impute bujqësore të padeklaruar dhe jo të lejueshme për tregtim. Në mjet u gjetën edhe 10 kg dispers, 20 kg fungucid origjina greke, 10 kg plehrues organik theocål, 100 kg npk kompleks si dhe 1 litër plehrues gjethor Boroplus, me etiketë në gjuhën greke. Këto impute bujqë-

sore janë të paregjistruara në listën e preparateve dhe e mbrojtjes së bimëve, miratuar nga MBZHR si dhe në mungesë të plotë të dokumentacionit, që bie në kundërshtim me ligjin 9362, nenet 13,14,23 për mbrojtjen e bimëve. Po ashtu, AKU bllokoi edhe një tjetër automjet privat, në të cilin u gjetën 72 kg mjaltë, produkt pa etiketë dhe asnjë dokumentacion certifikues të cilësishë dhe sigurisë. Konkretisht, nga kontrolli fizik i produktit, rezultoi se shtetasi grek, Argiropulos Thoma me automjetin e tij tip "BMW" me targë "KAH-9194" tentoi të fuste në vendin tonë 72 kavanoza me mjaltë pa nr. lotti, datë prodhimi dhe datë skadimi.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
 SEKTORI I PROKURIMIT  
**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë, shirit plastik me numër identifikimi dhe letra fashetimi për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6.540.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktshmesme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
 BIC: STANALTR  
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përskrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë, shirit plastik me numër identifikimi dhe letra fashetimi për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 28 Gusht 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të blejë tokë në qendër të kryeqytetit

# Shpronësimet në Tiranë, 200 mln lekë për pronarët

## Rikualifikimi i sheshit "Skënderbej", oferta e qeverisë

Ornela Manjani

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kërkon të blejë tokë në zemër të kryeqytetit. Bëhet fjalë për pronë që arrijnë vlerën rreth 200 milionë, të cilat u përkasin 24 pronarëve. Pronat do të përdoren për fazën e dytë të rikualifikimit të sheshit "Skënderbej". Përmes një kërkesë për shpronësim publik, Ministria e Infrastrukturës u kërkon pronarëve që t'i shesin asaj pronën. Njoftimi është botuar në Fletoren Zyrtare dhe "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë të pronave që preken, pronarët dhe vlerën për secilin përfutues. "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë" shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban i sheshit "Skënderbej", faza e dytë, Tiranë. "Subjekti kërkesë i këtij projekti është Bashkia Tiranë", - thuhet në njoftim. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilat preken nga ky shpronësim, që konsistojnë në masën e vlerësimit, të llogarit në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerësimit të tokës në Republikën e Shqipërisë", për llogaritjen e vlerësimit "tokë arë" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur. Vlera totale e shpronësimit është 189.259.610 lekë, - thuhet në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Pritet përfundimi i marrëveshjes me pronarët e trullait dhe të objekteve për të përmblytur fazën e shpronësimit e cila më pas do të hapë rrugë nisjes së punës për rikualifikimin e sheshit në qendër të kryeqytetit.

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m <sup>2</sup> )	Sip. truall i prekur (m <sup>2</sup> )	Çmimi truall lekë/m <sup>2</sup>	Sip. obj. totale (m <sup>2</sup> )	Sip. obj. e prekur (m <sup>2</sup> )	Çmimi obj. lekë/m <sup>2</sup>	Vlera në lekë	Shënime në kartelë	Konfirmimi i ZVRPP-së
1	Alban Xhillari	truall	8150	1/364	71.60	71.60	66969				4,794,980.4		Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
2	Ilirna Holding sh.a	truall	8150	1/365	450.00	254.00	66969				17,010,126.0		Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
3	25 pronarë Deliu, Seferi	truall	8150	1/195	76.40	67.00	66969				4,486,923.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
4	Ilirna Holding sh.a	truall	8150	1/375	92.40	92.40	66969				6,187,935.6		Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
5	SHTBT	truall	8150	1/379	30.60	30.60					0.0		Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
6	Bashkëpronarët Gjinali, Asllani etj.	truall	8150	1/200	293.30	206.00	66969				13,795,614.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
7	Bashkëpronarët Gjinali, Asllani etj.	truall	8150	1/201	31.20	31.20	66969				2,089,432.8		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
8	Bashkëpr. Hoxholli, Deliu etj.	truall	8150	1/495	231.00	231.00	66969				15,469,839.0		Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
9	SHTBT	truall	8150	1/494	61.80	61.80					0.0		Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
10	SHTBT	shesh	8150	1/6	113.00	113.00					0.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
11	Vasil Beqari, Vladimir Beqari, Andon Beqari	truall	8150	1/229	180.00	78.00	66969				5,223,582.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
12	SHTBT	truall	8150	1/253	70.00	51.00					0.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
13	SHTBT	shesh	8150	1/249	68.70	68.70					0.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
14	Harun Miniri	ndërtesë	8150	1/6 - ND				108.00	108.00	24899	2,689,092.0	Në sektorin D dhe E të kartelës ka regjistrime aktive	Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
15	Nashije Sallaku, Irina Sallaku, Edhira Sallaku, Djana Sallaku	truall + godinë	8150	1/7	230.00	230.00	66969	230.00	230.00	27574	21,744,890.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
16	Harun Miniri	truall	8150	1/248	50.20	50.20	66969				3,361,843.8		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
17	SHTBT	truall	8150	1/378	32.68	32.68					0.0		Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
18	Tonc Koka, Kole Koka, Elisabeta Koka, Jolanda Koka	truall	8150	1/191	121.20	121.20	66969				8,116,642.8		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
19	Alban Xhillari	truall	8150	1/401	26.00	26.00	66969				1,741,194.0		Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
20	Mazilëm Baraku	truall	8150	1/413	24.00	24.00	66969				1,607,256.0	Në sektorin D të kartelës ka regjistrime aktive	Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
21	Mazilëm Baraku	truall	8150	1/414	24.00	24.00	66969				1,607,256.0	Në sektorin D të kartelës ka regjistrime aktive	Nr. prot. 18833/7, datë 21.6.2017
22	Harun Miniri	truall	8150	1/387	22.50	22.50	66969				1,506,802.5		Nr. prot. 1754/3, datë 30.3.2018
23	Andromaqi Kotorri	truall	8150	1/211	106.00	106.00	66969	20.00	20.00	32956	7,757,834.0	Mbi këtë truall ka 86 m <sup>2</sup> ndërtim pa leje	Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
24	Skender Çah	truall	8150	1/212	32.00	32.00	66969				2,143,008.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
25	FPV	truall	8150	1/11	97.00	97.00	66969				6,495,993.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
26	FPV	truall	8150	1/12	177.2	177.20	66969				11,866,906.8	Mbi këtë truall ka ndërtim pa leje	Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
27	Shoqëria "Lani" sh.p.k., ortak i vetëm Vladimir Kosta	truall	8150	1/185	831.5	183.00	66969				12,255,327.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
28	Shefqet Dardari	truall	8150	1/484	35.9	35.90	66969				2,404,187.1		
29	Shefqet Dardari	truall	8150	1/374	191.00	38.00	66969				2,544,822.0		Nr. prot. 38958/1, datë 12.1.2018
30	SHTBT	truall	8150	1/492	795.55	795.55					0.0	Sipërfaqja dhe pozicionimi ndryshuan për efekt saktësimi dhe korigjimi të hartës me urdhrë korigjimi ref. 24845	Nr. prot. 1754/3, datë 30.3.2018
31	SHTBT	truall	8150	1/381	29.22	12.64					0.0		Nr. prot. 38958/1, datë 12.01.2018
32	SHTBT	truall	8150	1/500	36.2	36.20					0.0	Mbi këtë pasuri ndodhet pasuria ndërtesë 1/500-ND, vol. 48, f.	Nr. prot. 1754/3, datë 30.3.2018
33	Harun Miniri	ndërtesë	8150	1/500-ND				36.2	36.20	38193	1,382,586.6	52, në emër të Harun Miniri.	Nr. prot. 1754/3, datë 30.3.2018
34	Fatmir Mema	truall	8150	1/386/2	63.00	63.00	66969				4,219,047.0		Nr. prot. 1754/3, datë 30.3.2018
35	SHTBT	trobare	8150	1/3	2893.90	318.00					0.0		Nr. prot. 1147/1, datë 17.2.2017
36	SHTBT	rrugë	8150	1/5	607.10	577.80					0.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
37	SHTBT	shesh	8150	1/1	13059.00	60.00					0.0		Nr. prot. 1147/1, datë 17.2.2017
38	SHTBT	trobare	8150	1/8	677.00	523.20					0.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
39	SHTBT	rrugë	8150	1/9	1264.00	693.50					0.0		Nr. prot. 18833/11, datë 29.8.2017
40	SHTBT	shesh	8360	6/308	88.63	9.72					0.0		Nr. prot. 18833/1, datë 9.6.2017
41	Bashkëpronarët, Hachinaso, Antoni, Zografi etj.	truall	8360	6/205	44.20	10.70	66969				716,568.3		Nr. prot. 18833/1, datë 9.6.2017
42	SHTBT	trobare	8360	6/307	174.13	163.00					0.0		Nr. prot. 18833/1, datë 9.6.2017
43	SHTBT	trobare	8360	7/419	140.07	1.60					0.0		Nr. prot. 18833/1, datë 9.6.2017
44	Nazmi Kodra	truall + njësi	8150	1/386-N	65.60	65.60	66969	131	131.20	33468	8,784,168.0		Nr. prot. 1754/3, datë 30.3.2018
45	Fatmir Mema	truall + apartament	8150	1/386+1-1	65.60	65.60	66969	131.2	131.20	98038	17,255,752.0		Nr. prot. 1754/3, datë 30.3.2018. Saktësim dokumentacioni.
<b>TOTALI</b>						<b>5952</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>657</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>189,259,610</b>	<b>lekë</b>		

Fqinjët: Enkeleda ka qenë vetëm në banesë, nuk pamë njerëz të tjerë të dalin

# Vetëvritet bashkëshortja e gjyqtarit të Krimeve të Rënda, Dritan Hallunaj

Nëna e vajzës 7 vjeçe u hodh nga kati i 5 i pallatit ku banonte

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mesditën e djeshme në kryeqytet. Bashkëshortja e gjyqtarit të Krimeve të Rënda, Dritan Hallunaj i dha fund jetës duke u hedhur nga kati i 5-të i pallatit ku banonte, në kryqëzimin mes rrugës "Nikolla Tupe" dhe "Vaso Pasha", në zonën e ish-Blokut. Si pasojë e rënies, mësohet se 37-vjeçarja Enkeleda Hallunaj ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Rrethanat e kësaj ngjarjeje të rëndë nuk dihen ende. Dyshohet se viktima ka qenë e vetme në banesë dhe në kushtet e një gjendjeje të rënduar psikologjike ka ndërmarrë këtë veprim.

## NGJARJA

Enkeleda Hallunaj me profesion stomatologe është vetëvrarë duke u hedhur nga një pallat në rrugën "Vaso Pasha" në Tiranë. Sipas uniformave blu, ngjarja ka ndodhur ditën e djeshme në orën 13:16, ku 37-vjeçarja është hedhur nga ballkoni i banesës në katin e pestë. "Më datë 02.08.2018, rreth orës 13:16, në rrugën 'Vashko Pasha', dyshohet të jetë hedhur nga ballkoni i pallatit, shtetasja E. H., rreth 37 vjeçe, e cila ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Po punohet për sqarim të mëtejshëm të rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin e policisë. Enkeleda Hallunaj ishte me profesion stomatologe dhe punonte pranë Autoritetit Shëndetësor Racional në Tiranë. Dyshohet se 37-vjeçarja e ka ndërmarrë këtë veprim në kushtet e një gjendjeje të rënduar. Besohet se 37-vjeçarja, nënë e një vajze 7 vjeçe ka qenë e vetme në shtëpi kur ka ndodhur ngjarja. Duke iu referuar burimeve nga policia, dyshohet se gruaja vuante nga depresioni, pasi në banesë i janë gjetur anti-



Vendi ku ndodhi ngjarja



depressivë, por ende asgjë nuk është e konfirmuar. Në vendin e ngjarjes shkuan menjëherë ambulanca dhe makina policie, ndërsa efektivë të shumtë rrethuan zonën. Gjithashtu të pranishëm ishin edhe drejtues të policisë e prokurorisë, por edhe kolegë të gjyqtarit Dritan Hallunaj. Ndërsa fqinjët e familjes Hallunaj, që u bënë dëshmitarë të ngjarjes treguan minutat e para pas aktit tragjik. Ata kanë rrëfyer se kanë dëgjuar një zhurmë të fortë dhe kanë dalë jashtë. "Kemi dëgjuar një zhurmë, ishte aq e fortë sa nuk

e menduam se ishte një trup njeriu. Ka qenë vetëm në shtëpi, sepse nuk kemi parë njerëz të tjerë të dalin. Kanë qenë disa kalimtarë duke kaluar, janë tromaksur. Ne lajmëruam policinë menjëherë", u shprehën kalimtarët. Nuk dihet se cilat kanë qenë arsyet e këtij veprimi ekstrem, ndërsa në vendngjarje nisën menjëherë hetimet e para. Mësohet se gjyqtari i Krimeve të Rënda ishte në Shkodër kur mori vesh për ngjarjen, duke u nisur drejt kryeqytetit. Ngjarja e rëndë vjen një ditë pasi

bashkëshorti i saj, Dritan Hallunaj kaloi vetingun, duke u konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Gjyqtari doli i pastër në tri shyllat e kontrollit dhe nuk

## VETËVRASJA

"Më datë 02.08.2018, rreth orës 13:16, në rrugën 'Vashko Pasha' dyshohet të jetë hedhur nga ballkoni i pallatit, shtetasja E. H., rreth 37 vjeçe, e cila ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Po punohet për sqarim të mëtejshëm të rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin e policisë.

## Vetingu, konfirmohet në detyrë prokurori Gentian Osmani

Një tjetër prokuror kaloi me sukses ditën e djeshme vetingun. Sipas KKP, Gentian Osmani, një nga gjashtë prokurorët që po hetojnë ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, është i pastër në të tria shyllat e kontrollit. "KPK e konsideron të përfunduar secancën dëgjimore. Në përfundim të secancës së rivlerësimit, kjo trupë gjyqkuese vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentian Osmani", deklaroi rektorja e çështjes, Firdes Shulliu. Secanca dëgjimore u zhvillua tri ditë më parë, ndërsa Osmani zgjodhi të ballafaqohej personalisht me institucionin e vetingut. Prokurori Osmani kandidoi për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

## Tritoli në banesën e Gazmir Dacit, policia shpall në kërkim Sajmir Kolaverin

TIRANE - Një ditë pasi gjykata la në burg 23-vjeçarin Wilson Brahma, i cili akuzohet për vendosjen e tritolit në banesën e Gazmir Dacit në Kamëz, policia ka shpallur në kërkim shtetasin Sajmir Kolaverin. Ndonëse Brahma nuk tregoi porositesin, mësohet se i dyshuar për porositetin e shpërthimit të tritolit në 27 korrik në Bathore është Sajmir Kolaveri. Burimet sqarojnë se po kryhen të gjitha verifikimet, ndërkohë që pista kryesore është ajo e hakmarësjes, pasi Gazmir Daci është i dënuar me burg për vrasjen e Valmir Kolaverit dhe plagosjen e vëlait të tij, Robertit. Kujtojmë se Valmir Kolaveri u vra nëntorin e vitit 2015 në Kamëz, ndërsa Gazmir Daci u arrestua 1 muaj më pas si autor i kësaj ngjarjeje. Sipas dosjes së prokurorisë, në mbremjen e datës 4 nëntor 2015, rreth orës 18:00, Gazmir Daci ka qenë duke



udhëtuar me mjetin e tij privat të markës "BMW X5", në rrugën "Demokracia" në Kamëz, kur është hasur me Robert Kolaverin. Për shkak të konflikteve të vjetra, Gazmir Daci me një armë të tipit pistoletë në dorë ka shkuar në drejtim të mjetit ku ndodhej Robert Kolaveri. Në momentin e përbaljes fizike, ata janë konfliktuar me njëri-tjetrin me fjalë dhe në prag të përfundimit të konfliktit, Gazmiri e ka kanosur për vrasje Robertin. Pas largimit të Robertit, Gazmir Daci ka komunikuar në telefon me Valmir Kolaverin, i cili është edhe vëllai i Robertit. Në përfundim të kësaj bisede, Gazmiri ka shkua

me mjetin e tij në drejtim të njësisë tregtare, ku mendonte se ndodheshin dy vëllezërit. Në vazhdim e sipër të konfliktit, ai ka nxjerrë armën e tipit pistoletë, që kishte me vete dhe ka qëlluar me të në drejtim të Robert Kolaverit. Kur ky i fundit është rrezuar në tokë dhe vëllai i tij, Valmiri, ka marrë një send të fortë në tokë për t'u mbrojtur nga sulmi i armatosur i të pandehurit, por edhe ai është qëlluar në trup me armë nga i pandehuri dhe është rrezuar në tokë. Për shkak të plagëve të marra, Valmir Kolaveri ka gjetur vdekjen.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**  
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2.457.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përsëritje: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"**

Ofterta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 04 Shtator 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**SHKODËR** - Frrok Bregu, baba i 8 fëmijëve ka humbur dje jetën teksa po tentonte të rilidhte energjinë elektrike. Ngjarja ka ndodhur mesditën e djeshme në fshatin Bardhaj të Shkodrës. Burime zyrtare nga OSHEE bëjnë me dije se familja Bregu rezultoi të prej vitesh debitorë për shkak të mospagesës së faturave të energjisë elek-



## Hipi në shtyllë të rilidhte energjinë elektrike, humb jetën babai i 8 fëmijëve

trike, e cila prej 10 ditësh ishte ndërprerë. Në pamundësi për të paguar faturat, si pasojë e gjendjes së rëndë ekonomike në familje, 51-vjeçari tentoi të rilidhte energjinë e ndërprerë, çka

rezultoi fatale për kryefamiljarin, i cili gjeti vdekjen e menjëhershme. Mësohet se familja Bregu jeton në një shtëpi të rrënuar, të cilën ia kishte ndërnuar disa kohë më parë

kisha e fshatit. 8 pjesëtarët e familjes Bregu nuk kanë të ardhura të tjera përveç ndihmës ekonomike që marrin nga shteti dhe ndihma në veshmbathje që i jepje kisha.

Familjarët e viktimës: E vranë sepse ndërhyri për të mbrojtur një vajzë

# Itali, ekzekutohet me 2 plumba pas shpine 23-vjeçari shqiptar

## Autorët me "Scooter" e qëlluan të riun nga Mirdita në mes të sheshit të mbipopulluar

ITALI

Një 23-vjeçar shqiptar u ekzekutua mbrëmjen e së mërkurës në Bari të Italisë. Sipas "Ansa"-s, viktimë është Viktor Picaku i padënuar me parë. Ngjarja e rëndë ku mbeti i vranë i ri shqiptar ndodhi rreth orës 21:35 në sheshin "Abbazia" të Coratos, (provincë e Barit), në praninë e dhjetëra personave që kishin mbushur vendin. Nga informacionet paraprake mësohet se kanë qenë dy persona që lëviznin me një motor "Scooter", që e kanë qëlluar 23-vjeçarin pas shpine. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar mjekët, të cilët janë përpjekur të reanimojnë të riun. Por, plumbat e autorëve e kishin kapur shqiptarin në kokë dhe në gjoks (mushkëri) duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme. Ndërkaq, policia italiane ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të motivit të ngjarjes si dhe identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Sipas burimeve të mësipërme, viktimë bënte punë të ndryshme në fshat, ndërsa kishte precedentë të vegjël. Pas kryerjes së veprimeve paraprake hetimore në vendin e ngjarjes, hetuesit e çështjes pohuan se ekzekutimi i të riut nuk kishte të bënte me krimin e organizuar. Autoritetet kanë sekuestruar kamerat e sigurisë që ndodheshin në zone. Hetimet po zhvillohen në disa pista, ndërsa nuk përjashtohet mundësia që të jetë krim pasioni. Gjatë natës u morën në pyetje disa persona, mes të cilëve pjesëtarë të familjes Picaku, miq të 23-vjeçarit si dhe dëshmitarë okularë të ngjarjes. Hetimet koordinohen nga gjykatësja e Prokurorisë së Tranit, Raffaella De Luca.

### REAGIMI I FAMILJARËVE

Të afërmit e Viktor Picakut (me origjinë nga Mirdita), që u vra në mes të sheshit të populluar me njerëz në Bari të Italisë, dyshojnë se pas kësaj ngjarjeje të rëndë fshihet një italian. Për "tvklan.al", ata rrefyeshen pak ditë më parë, Viktori kishte ndërhyrë për të mbrojtur një vajzë, e cila po dhunohej nga një italian. Familjarët thanë se 23-



23-vjeçari i vranë, Viktor Picaku



Vendi ku ndodhi ngjarja

Miqtë e shqiptarit të vranë, mesazhe prekëse: Do na mungosh vëlla, ata do e paguajnë!

Miqtë e shqiptarit Viktor Picakut që u ekzekutua mbrëmjen e kaluar në Corato, Bari, kanë postuar një sërë mesazhesh pas humbjes së 23-vjeçarit. Në rrjetet sociale ata e kanë përshkruar Viktorin si një mik të mirë, ndërsa nuk kanë munguar kërcënimet për autorët e krimit që i morën jetën të riut shqiptar. "Të njihja prej pak kohësh, por e ndieja se ishte një person i mrekullueshëm, tani me siguri ndodhesh në një vend më të mirë se i yni, pusho në paqe miku im", shkruan një prej miqve. Por aq sa kuptohet nga rrjetet so-



ciale, 23-vjeçari pjesën më të madhe të miqve e kishte italianë, e pikërisht ata i kanë dhënë lamtumirën në rrjetet sociale, duke e kujtuar mikun e tyre me mesazhe prekëse. "Vëlla, pusho në

paqe, do të jesh përgjithmonë në zemrën time, pa fjalë vëlla", shkruan një tjetër mik i Viktorit. "Do ta paguani", shkruan një shoqe e viktimës, duke kërcënuar autorët.

mërkurës mori hak ndaj të riut, duke i marrë atij jetën. Gjithashtu, të afërmit e viktimës u shprehën se kanë mësuar se një prej autorëve është vetëdorëzuar në polici, ndërsa tjetri është ende

në kërkim. Siç raportojnë edhe mediat italiane, në mesin e pistave të hetimit nga autoritetet atje, është edhe ajo e xhelozisë. "Viktoriani nuk rezultoi person me precedentë penalë dhe punonte

në kërkim. Siç raportojnë edhe mediat italiane, në mesin e pistave të hetimit nga autoritetet atje, është edhe ajo e xhelozisë. "Viktoriani nuk rezultoi person me precedentë penalë dhe punonte

### U gjenden kokainë e mijëra euro, bien në pranga 2 shqiptarë

Dy shqiptarë janë arrestuar nga karabinierët në zonën e Baldas në Itali. Shtetasit me inicialet P.K. dhe M.S., respektivisht 21 e 24 vjeç u prangosën, pasi gjatë një kontrolli iu janë gjetur disa gramë kokainë, mijëra euro dhe municion të kalibrit të vogël. Sipas mediave lokale, dy të rinjtë shfaqën nervozizëm teksa panë patrullën e policisë, të cilët nisën menjëherë një kontroll të imtësishtëm. Kokaina dhe paratë u sekuestruan, ndërsa dy shqiptarët u arrestuan për shpërndarje të drogës dhe mbajtjen e municioneve luftarake.

### SHKURT

#### Shpërthim me eksploziv në banesën e emigrantit

**LEZHË** - Një shpërthim me eksploziv ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në fshatin Zejmen të Lezhës. Mësohet se shpërthimi ka ndodhur në banesën e shtetasit Albert Hasani, aktualisht emigrant në Belgjikë. Fatmirësisht nga shpërthimi nuk ka persona të lënduar, por vetëm dëme materiale. Menjëherë policia ka nisur hetimet për ngjarjen që shkaktoi panik tek banorët e fshatit. Nuk dihet ende motivi i kësaj ngjarjeje, ndërsa blutë po hetojnë për identifikimin e autorëve.

#### Zjarri shkruan burime, s'ka persona të lënduar

**DIBËR** - Dy ditë më parë, një çer dhe në Dibër është përfshirë nga flakët. Sipas informacioneve zyrtare, zjarri ka rënë rreth orës 08:00 të së martës në çerdhen nr. 1 të qytetit të Peshkopisë. Fatmirësisht janë shkaktuar vetëm dëme materiale dhe jo persona të lënduar, pasi në çerdhe nuk pasur fëmijë. Ndonëse u dyshua si një zjarrvënje e qëllimshme, burime nga policia pohuan se dyshohet që zjarri ka qenë aksidental. Megjithatë, blutë po punojnë për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

#### Del me leje nga burgju, shqiptari ther kunatin

**ITALI** - Një i burgosur shqiptar me gjysmë liri nuk është rikthyer në qeli pas përfundimit të orarit të punës. 45-vjeçari, i dënuar për drogë, prostitucion dhe armëmbajtje punonte me kohë të pjesshme në një kompani. Institucioni i vuajtjes së dënimit e lejonte atë që të punonte jashtë burgut dhe më pas kthehej sërish në qeli. Por kësaj radhe, shqiptari nuk është kthyer. Sipas TV "Klan", ngjarja ka ndodhur në Torino të Italisë. Sipas mediave lokale, ai ishte takuar me kunatin e tij egjiptian në periferi të Torinos. Pas një debati 45-vjeçari e ka goditur me thikë kunatin e tij. Ky i fundit u dërgua në spital, ndërsa shqiptari është në kërkim.

#### Kapen 18 kg drogë, arrestohet shqiptari

**GREQI** - Policia greke ka sekuestruar rreth 18 kg marijuanë në kufirin greko-shqiptar. Pas informacioneve të dhëna nga policia shqiptare, policia e Igumenicës ndaloj në Sadjdhë një automjet, brenda të cilit u gjetën dhe sekuestruan 26 pako me 17 kg 474 gr drogë. Në pranga ra drejtuesi i mjetit. Bëhet fjalë për 19-vjeçarin Angel Sullaj nga Saranda. Ndërsa është në kërkim organizatori i trafikut, një 28-vjeçar shqiptar. Gjithashtu, u sekuestruan edhe 600 euro.



"Pas saj fshihet një grup radikal, çdo akt që ajo bën, i diktohet nga komanda muxhahedine"

Ina Allkanjari

**S**hqiptarë, më ndihmoni që të liroj vajzën time nga grupi i muxhahedinëve iranianë!". Kështu është shprehur në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Mostafa Mohammadi, i cili akuzon organizatën MEK se po i mban peng vajzën e tij. Reagimi i tij vjen një ditë pas publikimit të intervistës së Sommayeh Mohammadi në 'GSH', e cila këmbëngul se nuk është peng e muxhahedinëve dhe se nuk dëshiron t'i takojë familjarët e saj. Por, Mostafa shprehet se pas vajzës fshihet një grup radikal dhe çfarëdo akti që ajo bën në këtë organizatë, është e diktuar nga komanda e lartë ushtarake. "Nëse komanda muxhahedine i jep urdhër vajzës sime të bëhet kamikaze, ajo bëhet kamikaze. Nëse komanda i thotë do e dënosh babain tënd si armik, ajo duhet ta bëjë këtë. Letra që ju keni botuar në gazetën tuaj nuk është nga vajza ime, por nga komanda e lartë muxhahedine, e cila nuk do që vajza ime të dalë e lirë dhe të bashkohet me familjen e saj", u shpreh Mostafa Mohammadi.

**Ju insiston se MEK mban peng vajzën tuaj prej 20 vitesh. Kjo gjë është mohuar nga Sommayeh, çfarë ju shtyn të mendoni se vajza po mbahet kundra dëshirës?**

Vajza ime është peng i organizatës MEK. Organizata e muxhahedinëve iranianë është një organizatë ushtarake. Vajza ime është pjesë e kësaj strukture ushtarake, e cila anëtarët e saj i trajton si robotë. Vajza ime është pjesë e këtij grupi radikal dhe çfarëdo akti që ajo bën në këtë organizatë, është e diktuar nga komanda e lartë ushtarake. Nëse komanda muxhahedine i jep urdhër vajzës sime të bëhet kamikaze, ajo bëhet kamikaze. Nëse komanda i thotë do e dënosh babain tënd si armik, ajo duhet ta bëjë këtë. Letra që ju keni botuar në gazetën tuaj nuk është nga vajza ime, por nga komanda e lartë muxhahedine, e cila nuk do që vajza ime të dalë e lirë dhe të bashkohet me familjen e saj. Shumë dezertorë të organizatës që janë në Tiranë dhe kanë braktisur xhihadin e MEK-ut dëshmojnë që vajza ime nuk është e lirë. Ajo qëndron e izoluar në kampin xhihadist të Manzës dhe ne kemi parë vetëm letra të saj, që y lëshohen meadije.

**Gjatë një interviste për 'GSH', vajza është shprehur se pas jush fshihet regjimi iranian. Ajo shprehet se ju jeni agjent i Ministrisë së Inteljencës së një regjimi që e cilëson "vrasës", si qëndron e vërteta?**

Vajza ime është rrëmbyer nga MEK-u që kur ishte 17 vjeçe. Xhihadistët e MEK-ut e lanë pa mbaruar shkollën e mesme, pa shkuar në universitet, pa i martuar, pa u integruar në jetën kanadeze, pa bërë fëmijë e familje dhe tani pas 21 vjetësh në izolim, ju mendoni se vajza ime e di se kush jam unë? Ku e di vajza ime që unë jam një agjent iranian? Ajo është në burgun e muxhahedinëve si skllave prej 2 dekadash. Ajo nuk ka parë gjë tjetër me sy në këto 2 dekada, por vetëm luftë në Irak, jetë në mes të shkrretirës dhe tani izolim në kampin ushtarak të Manzës. Vajza ime sikur edhe muxhahedinët e tjerë në këtë kamp nuk shohin televizor, nuk kanë telefona, nuk kanë internet, nuk lexojnë dot as libra. E vetmja gjë që di vajza ime është trushpëlarja që i bëjnë komandantët e saj natë e ditë, duke i thënë që Irani ka lëshuar agjentët për të na vrasur, por që ne do e fitojmë luftën tonë xhihadiste. Nëse unë do isha vrasës, qeveria kanadeze dhe amerikane do më kishin dënuar dhe çuar në Guantanamo dhe Kanadaja nuk do më jepte statusin e azilantit politik. Unë nuk jam agjent iranian. Unë jam shtetas kanadez, një prind që dua të çliroj vajzën time nga pengmarrja e grupit xhihadist iranian.

**Sommayeh ka depozituar një kallëzim penal në polici, duke ju akuzuar për përnd...**

# Mostafa Mohammadi: Shqiptarë, më ndihmoni të liroj vajzën time

## "Sommayeh është peng e organizatës MEK prej 20 vitesh"



Mostafa Mohammadi dhe bashkeshortja

**Je kje. Çfarë mund të na thonit në lidhje me këtë çështje?**

Depozitimi në emër të Sommayes erdhi 4 ditë pasi unë kallëzova MEK-un për pengmarrje të vajzës sime. MEK-ut, që është në panik nga padia ime, arriti që pas 4 ditësh dhumë psikologjike të bindë vajzën time të nënskruajë një letër, ku ajo thotë që unë e përndjek. MEK-ut donte të më trembte me këtë padi dhe të më detyrojë mua që të largohem nga Shqipëria dhe ta braktis vajzën time në duart e xhihadistëve. Por unë u gëzova nga kjo padi. Sepse me këtë padi unë shpresoj që të shoh vajzën time në sallën e gjyqit dhe para gjyqtarit t'i them që ajo nuk jeton në Irakun e Sadam Huseinit, por në Shqipërinë liberal-demokratike. Në sallën e gjyqit unë do kërkoj nga gjyqtari që ai të përjashtojë gestapon muxhahedine nga sala dhe aty, pa prezencën e terroristëve muxhahedinë, do i them vajzës sime që të kthehet në familje, te ne në Kanada. Do i kërkoj gjyqtarës që t'i tregojë Sommayes së trembur - që nëse ajo do - mund ta braktisë kultin xhihadist dhe mund të dalë nga sala e lirë, pa frikë se MEK-ut mund ta vrasë.

**Cili është shkaku i ardhjes suaj në Shqipëri?**

Në Shqipëri kam ardhur së bashku me gruan time që të takojmë vajzën tonë, të cilën nuk e kam takuar që nga viti 2005. Jam duke shkuar në zyra, ministri, polici, gjykata, avokatë etj. dhe po kërkoj gjithandëj që shteti shqiptar të më takojë me vajzën time, e cila më është rrëmbyer nga një grup i dhunshëm dhe ekstremist. Dua që të takoj vajzën time dhe ta bind që xhihadi dhe lufta

nuk janë opsioni për të ndryshuar botën. Por muxhahedinët nuk po na lënë ta takojmë fëmijën tonë, pse ata kanë frikë, se nëse ne e takojmë vajzën tonë, do të mundim ta deradikalizojmë, ta bindim që ne nuk

**Vajza ime është peng i MEK.**

Organizata e muxhahedinëve iranianë është një organizatë ushtarake. Vajza ime është pjesë e kësaj strukture ushtarake, e cila anëtarët e saj i trajton si robotë.

medhenj. Ata kanë bërë me mijëra vrasje në Iran, Irak, Evropë etj. Deri në vitin 2012 ata ishin listuar si organizatë terroriste nga OKB-ja, SHBA-të etj. Por edhe pse ata kanë një të kaluar kriminale, tani luajnë viktimën. Gënjëjnë dhe përdoren nga disa qeveri të caktuara kundër Iranit. Hipokrizia e tyre shkon aq thellë, sa që na akuzojnë edhe ne, prindërit e Sommayes, dy pleq kanadezë si terroristë dhe komplotistë kundër

jemi agjentë iranianë dhe vrasës, por jemi mamaja dhe babai i saj dhe i duam asaj të mirën.

**Vajza ndihet e kërcënuar nga prezenca juaj dhe është shprehur që prania juaj tregon se regjimi iranian po planifikon të k o m p l o t o j ë kundër MEK. Pse ky reagim i Sommayes?**

Muxhahedinët janë hipokritë dhe manipulatorë të medhenj. Ata kanë bërë me mijëra vrasje në Iran, Irak, Evropë etj. Deri në vitin 2012 ata ishin listuar si organizatë terroriste nga OKB-ja, SHBA-të etj. Por edhe pse ata kanë një të kaluar kriminale, tani luajnë viktimën. Gënjëjnë dhe përdoren nga disa qeveri të caktuara kundër Iranit. Hipokrizia e tyre shkon aq thellë, sa që na akuzojnë edhe ne, prindërit e Sommayes, dy pleq kanadezë si terroristë dhe komplotistë kundër

Kam kontaktuar me UNHCR dhe RAM-SA-n dhe ata më kanë treguar që vajza ime është këtu, por që nuk bëjnë dot gjë për lirinë e vajzës sonë, pasi MEK-ut është nën mbrojtjen e Amerikës dhe qeverisë shqiptare. Pas kësaj i jam drejtuar policisë dhe prokurorisë dhe kam ngritur padi kundër MEK-ut për pengmarrjen dhe izolimin e vajzës sime. Jam duke lëvizur çdo gur ligjor dhe policor që të takoj vajzën time. Nëse shteti shqiptar nuk më ndihmon, pas kësaj do u drejtohem organizatave evropiane që të ndërhyjnë dhe të lirojnë vajzën time nga pengmarrja e grupit xhihadist iranian.

**Prej sa vitesh keni humbur kontakt me Sommayeh? Ju thonë që e vetmja gjë që dëshironi së bashku me bashkeshortën është të takoni vajzën tuaj. Mendoni se ky takim do sjellë ndonjë ndryshim?**

Për herë të fundit Sommaye e kemi takuar në vitin 2005. Prej kësaj kohe MEK-ut nuk na ka lejuar më. Kam bërë shumë përpjekje për të takuar vajzën time. Një rast është në vitin 2009 kur me 15 familje iraniane kam shkuar në kampin Ashraf dhe bërtisja me altarpalantë para kampit dhe të gjithë në thërrisnim fëmijët tanë që të dalin jashtë kampit. Këtë rast, muxhahedinët përmendin në intervistat e tyre kundër meje. Dhe më akuzojnë si agjent iranian, pse unë flisja me altarpalantë në dyert e kampit xhihadist dhe kërkoja që gestapo e MEK-ut të lirointe vajzën tonë. Në këtë kohë, MEK-ut ishte ende organizatë terroriste sipas OKB-së. Prezenca ime në Shqipëri është përpjekja e



Familja e Sommayeh

MEK-ut. Më akuzojnë mua, një punëtor krahu nga Kanadaja, për agjent iranian.

**A u jeni drejtuar institucioneve shtetërore për ndihmë lidhur me pretendimet që keni se vajza juaj po mbahet peng? Nëse po, cili ka qenë reagimi?**

I jam drejtuar Ministrisë së Brendshme. Për fat të keq, drejtori i azilit, Sokol Sheti na ka gënjyer me ditë të tëra dhe na thoshte që vajza jonë nuk është në Shqipëri. Por fatmirësisht, MEK-ut na ndihmoi me letër që botoi kundër nesh dhe pas kësaj e mësuam që vajza jonë është në Shqipëri dhe mbahet peng nga MEK-ut.

fundit për të liruar vajzën time nga ky grup i dhunshëm xhihadist.

**Cili është apel juaj?**

Shqiptarë, më ndihmoni që të liroj vajzën time nga grupi i muxhahedinëve iranianë! Vini dorën në zemër dhe mendoni si për veten tuaj. Nëse ju sot braktisni vajzën time, një ditë xhihadistët do marrin fëmijët tuaj dhe do i çojnë në xhihad në Siri, Iran dhe gjithë botën dhe do i bëjnë terroristë. Vini dorën në zemër dhe kuptoni dhimbjen që një nënë dhe baba ka kur e shohin vajzën e tyre të marrë peng nga një grup i dhunshëm dhe ekstremist.

**Përmbuesi gjyqësorë Genti Bushati nxjerr për shtjete ne ankand pasurine :**

a) **Toke are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurine 5921, volumi 10, Faqe 248, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 3230 m<sup>2</sup>, e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder**

b) **Toke are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurine 52321, volumi 9, Faqe 3, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 350 m<sup>2</sup>, e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder.**

z. **Cmimi me të cilin do të llogjë shtjete ne Ankand për pasurinë e sipërscrikuar, është ne vleren a) Për pasurinë "Toke Are" me sip 3230 m<sup>2</sup>, është ne vleren 439,538 leke. b) Për pasurinë "Toke Are" me sip 2360 m<sup>2</sup>, është ne vleren 321,148 leke**

Shtjete pasurise do te behet (zhvillohet) me date 06.08.2018 ora 16.16 ne zyrën e përmbuesit gjyqësorë Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Perballë Gjykatës se rrethit Gjyqësorë Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen para fillimit te ankandit 10% te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.

**STRATI** Shoqëria përmbairmore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shtjete për shtjete ne ankand te pasurive te paluajtshme:

"Njësi" me sipërfaqe 62 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Lagjja "Kongresi Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 512744-2, Zona Kadastrale 6521, Volumi 34, Faqe 193, lënë si garanci bankës për kontratë së hipotekës Nr. 139 Rep., dhe Nr. 402 Kot., datë 19.01.2008. Cmimi fillestar i ankandit është 11,577,384 Lekë.

**Ankand për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 08.08.2018.**


Ankand për pasurinë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbairmore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**NJOFTIM**

Ne date **08.08.2018** ne oren **16.00** ne zyrën e përmbuesit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankand për shtjete e pasurise se paluajtshme te lojtit **"Apartment"** me sip. **68 m<sup>2</sup>**, me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjja 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5, Ure Vajguore Berat.Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren **1,411,200 (nje milion e katerqind e njemdhjetë mije e dyqind) leke.**

# Shëndetësi

Sipas studimeve mjekësore është arritur në konkluzionin se një zemër e dhjamosur është më e predispozuar për t'u dëmtuar se një zemër normale. Në stinën e verës duhet bërë shumë kujdes për zemrën, pasi rritja e temperaturave mund të ndikojë në uljen e rrahjeve të organit, e kështu edhe në uljen e tensionit. **Ataku në zemër është një dukuri që ndodh shpesh tek individët që kanë probleme me tensionin apo me zemrën sidomos kur janë në det.**



Mjeku popullore: Si të veproni për të parandaluar atakun, ndihma e shpejtë

Voltiza Duro

Zemra është organi që punon gjithë jetën e njeriut pa pushuar, e si pasojë lind si nevojë e domosdoshme që të kujdeseni për të, pasi mund të dëmtohet drejtpërdrejt nga mënyra e jetesës dhe të ushqyerit. Ky organ mund të dëmtohet lehtësisht, por pavarësisht kësaj, mund ta rigjeneroni atë e ta ktheni në formë normale. Vdekjet në lidhje me sëmundjet e zemrës vijnë gjithmonë duke u rritur. Shumica e njerëzve në ditët e sotme vuajnë nga stresi, e disa arrijnë t'i përballojnë pa u shqetësuar, por ka të tjerë që janë më të ndjeshëm ndaj problemeve e si pasojë dëmtojnë zemrën pa kuptuar. Periudha e verës gjithashtu ndikon në përqendrimin e punës së zemrës, enët e gjakut zgjerohen shumë dhe ky organ lodhet duke pompuar gjakun në këto enë të zgjeruara, sidomos tek individët që kanë varice, yndyra të larta, probleme me anktin etj. Sipas studimeve mjekësore është arritur në konkluzionin se një zemër e dhjamosur është më e predispozuar për t'u dëmtuar se një zemër normale. Në stinën e verës duhet bërë shumë kujdes për zemrën, pasi rritja e temperaturave mund të ndikojë në uljen e rrahjeve të organit, e kështu edhe në uljen e tensionit. Ataku në zemër është një dukuri që ndodh shpesh tek individët që kanë probleme me tensionin apo me zemrën sidomos kur janë në det.

### SIMPTOMAT KRYESORE

Personat që kanë probleme me zemrën mund të kenë simptoma të ndryshme në plazh si ndryshim të tensionit; fryrje të këmbëve dhe krijim të disa vijave të kuqe në pjesën e fundit të këmbës. Gjithashtu, mund të shfaqet edhe një errësim i enëve të gjakut te këmbët apo fryrje e rrahëve të syve. Këto ndodhin për shkak të dobësisht të aftësisë së zemrës për të pompuar gjakun dhe kështu ky i fundit grumbullohet së bashku me ujë të tepërt

# YLLI MERJA: Si të keni një zemër të shëndetshme në stinën e verës

*"Konsumoni çaj boronice, perime dhe salmon"*



Mjeku popullore Ylli Merja

në pjesën e poshtme të këmbës.

### KATEGORITË E PREDISPOZUARA

Të gjithë duhet të kujdesemi për zemrën gjatë temperaturave të larta, por në veçanti njerëzit mbipeshë, të moshuarit, ata që konsumojnë duhan, ata që vuajnë nga tensioni i lartë ose i ulët si dhe personat me diabet duhet të bëjnë më

shumë kujdes. Sipas shumë studimeve kërkimore, ka rezultuar se qëndrimi në ujë të ftohtë kur temperatura e ajrit është e lartë dhe dielli i fortë mund të shkaktojë atak në zemër, pra pushim të menjëhershëm të zemrës. Nëse shikoni dikë me buzë të nxirë në det, do të thotë se është paralajmërim i moshës funksionimit normal të zemrës, prandaj ai individ

duhet të dalë menjëherë nga deti. Kjo dukuri ndodh te të gjitha moshat, fëmijë dhe të

rritur. Uji i ftohtë i detit mund të sjellë vdekjen e menjëhershme, sepse shkakton çrregullim të rrahjeve të zemrës.

### SI MUND TA PARANDALOJMË?

Uji i ftohtë i detit ka shumë efekte pozitive në organizëm, pasi ndihmon në tonifikimin e trupit, por hyrja e menjëhershme është shumë e dëmshme, sepse 'shokon' trupin. Në momentin që uji i ftohtë vjen të këmbët, personi ndjen vetëm pak të ftohtë të tepërt, por kur ky ujë prek në kraharor individit ndjen shumë ftohtë dhe dridhje të menjëhershme. Kjo ndodh sepse uji i ftohtë prek direkt zemrën dhe ndikon në ndryshimin e corientimin e rrahjeve të saj. Mënyra më e fiksuar për të mbrojtur zemrën është të lageni pak me ujin e ftohtë,

të lagni zonën përpara kraharorit dhe pastaj mund të futeni tërësisht dhe të shijoni freskinë e detit. Nëse shikoni një individ që ka shtrëngim në kraharor, ka buzën të nxirë dhe mendon se ka dhimbje të forta në zemër mos u trembni, por reagoni menjëherë për ta shpëtuar. Një aspirinë e vendosur nën gjuhë dhe qetësimi i personit në hije është shumë i domosdoshëm. Aspirina qetëson muskujt e zemrës, e ndihmon që ajo të ushqehet me më shumë oksigjen. Në të gjitha ato raste kur një person ka humbur ndjenjat në det apo pasi sapo ka dalë nga deti, si fillim këshillohet të shtypni një aspirinë me dhembë pa humbur kohë, vendosani nën gjuhë dhe menjëherë duhet t'i bëni frymëmarrje artificiale dhe shtypje të gjoksit me shpejtësi, pra t'i jepni ndihmën e parë. Kjo ndihmon riaktivizimin e zemrës, ndihmon që t'i jepni organizmit oksigjen dhe sidomos zemrës dhe trurit. Kjo ndihmë e parë është kritike për individin, pasi ju mund t'i shpëtoni jetën. Edhe nëse personi ka gëlltitur ujë në det gjatë shtypjes në kraharor uji del jashtë. Këshillohet që kur të shkoni në plazh të konsumoni çdo ditë një gotë me çaj jeshil dhe çaj me boronice në mëngjes dhe kështu jeni shumë të mbrojtur nga goditjet në zemër. Boronica ka vlera të shumta në pastrimin e gjakut dhe enëve të tij, ushqen muskujt e zemrës dhe trurit dhe nuk lejon dëmtimin e tyre nga ndryshimi i madh i temperaturave.

### USHQIME TË DOMOSDOSHME PËR SHËNDETIN E ZEMRËS:

- Salmoni, pasi përmban yndyra të shëndetshme omega-3 e ndihmon në mbrojtjen nga aritmia dhe arterioskleroza. Është ushqimi më i shëndetshëm për zemrën dhe trurin.
- Tërshëra pasi ul kolesterolin, përmban fibra të shëndetshme dhe pastron organizmin nga toksinat.
- Boronica e zezë përmban antocyaninë dhe flavonoide, të dyja antioksidantë të fuqishëm që i shërbejnë zemrës.
- Çokollata e zezë ul rrezikun e goditjes në zemër.
- Portokallet dhe mandarinat përmbajnë flavonoide dhe vitaminë C, largojnë bllokimet në arterie e hollojnë gjakun.
- Soja ul tensionin e gjakut, përmban proteina që ulin LDL si dhe ka fibra dhe minerale të shumta.
- Patatet përmbajnë shumë potasium dhe ulin tensionin e gjakut.
- Domatet përmbajnë shumë potasium, ushqejnë enët e gjakut, ulin rrezikun e sëmundjeve të zemrës.
- Konsumoni gjithashtu perimet, fasulet, verën e kuqe, çajin jeshil, brokolin, spinaqin, kafe në sasi të vogla, fara liri. Këto ushqime janë të bollshme në verë dhe lehtësisht të gjendshme.



## "Nuk mund të qëndroni më shumë se 6 muaj" Viza turistike në SHBA, ambasada: Rregullat që s'duhet t'i shkelni

Ditën e djeshme ambasada amerikane në Tiranë u ka bërë thirrje të gjithë atyre që do të shkojnë në SHBA me viza turistike që t'i përmbahen rregullores. "E dimë se shumë njerëz do të udhëtojnë për në SHBA këtë verë. Ne shpresojmë që t'ia kaloni sa më mirë, por kini parasysh që është shumë e rëndësishme të zbatoni rregullat e vizës gjatë vizitës suaj në Shtetet e Bashkuara", - theksojnë ekspertët e ambasadës.

### RREGULLORJA

Të gjithë aplikantët duhet të kenë parasysh që viza turistike ka për qëllim një qëndrim për një kohë të shkurtër në SHBA dhe nuk jepet për të jetuar në SHBA dhe as për të punuar atje. "Ju

mund të gjendeni i papranueshëm sipas ligjit të imigracionit. Në përgjithësi, duhet të qëndroni për aq kohë sa keni deklaruar në aplikimin për vizë. Gjithashtu, brenda një viti nuk mund të qëndroni më shumë se gjashtë muaj në total, ose edhe më pak, sipas autorizimit nga oficeri i imigracionit", - theksojnë ekspertët e ambasadës. Kështu, me vizë turistike është e ndaluar puna në SHBA. Nëse oficer i imigracionit ngre dyshime që qëllimi i vizitës së individit nuk është turistik, por për punë, atij mund t'i re-

### EKSPERTET

"Ju mund të gjendeni i papranueshëm sipas ligjit të imigracionit. Në përgjithësi, duhet të qëndroni për aq kohë sa keni deklaruar në aplikimin për vizë. Gjithashtu, brenda një viti nuk mund të qëndroni më shumë se gjashtë muaj në total, ose edhe më pak, sipas autorizimit nga oficeri i imigracionit", - theksojnë ekspertët e ambasadës.

kovohet viza. Zyrtarët e kufirit të Shteteve të Bashkuara përcaktojnë se sa kohë mund të qëndrojnë fituesit e vizës turistike në Shtetet e Bashkuara. Për shumicën e mbajtësve të vizave të vizitorit (B1/B2), koha maksi-

male e qëndrimit është në përgjithësi gjashtë muaj në një vit kohor. Studentët, vizitorët e programeve të shkëmbimit dhe punëtorët e përkohshëm janë në përgjithësi të pranuar për kohëzgjatjen e statusit. Pa-



varësisht nga kjo, për të shmangur në të ardhmen problemet me vizën apo me hyrjen në Shtetet e Bashkuara, qëllimi dhe koha e qëndrimit në Shtetet e Bashkuara duhet të jetë në përputhje me çfarë kandidati ka

thënë në aplikimin për vizë. "Një vizë nuk garanton hyrjen në SHBA, por ju lejon të vini nga jashtë e të udhëtoni në pikën e hyrjes në SHBA dhe të kërkonte leje për të hyrë në SHBA.

Voltiza Duro

Vendimi i Këshillit Bashkiak/ Do të përzgjidhen 16 fituesit më të mirë, sa do të shpërblehen

# Intership 3-mujor në Bashkinë e Tiranës, zbardhen formularët e aplikimit

## Katër fazat e projektit, data e fundit e kandidimit

Të gjithë ata të rinj deri në 28 vjeç që kanë përfunduar studimet e larta në ciklin e parë apo të dytë, mund të aplikojnë për të fituar një intership 3-mujor në Bashkinë e Tiranës. Deri në datën 7 gusht të këtij viti, të interesuarit do të kenë mundësinë të aplikojnë me një koncept për projekt ose studim sipas temave të përcaktuara. Nëpërmjet konkurrimit, do të përzgjidhen 16 fituesit me idetë më të mira, të cilët më tej do të punojnë nga afër me stafin e Bashkisë së Tiranës për të finalizuar studimin ose shkrimin e plotë të projektit. "Fillim me një ide - Fitim një intership në Bashkinë të Tiranës" është projekt i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 29 datë 29.03.2018. Në përfundim të intershipit do të jepet çmimi në vlerë monetare 62.500 lekë/personi (bruto) dhe certifikat për pjesëmarrje. Për informacion të mëtejshëm rreth mënyrës së aplikimit, aplikantët mund të dërgojnë një kërkesë për informacion në adresën elektronike:

fitonjeinternship@tirana.al, - theksohet në njoftimin e Bashkisë së Tiranës. "Gazeta Shqiptare" publikon sot për të gjithë të interesuarit të dy formularët e aplikimit: formën A për projektet si dhe formën B për studimet.

### FAZAT E PROJEKTI

Ky projekt i bashkisë së kryeqytetit është ndarë në katër faza nëpër të cilat do të kalojnë aplikantët. Faza e parë është aplikimi ku objektivi i thirrjes për koncept-ide për projekte/studim është të mundësojë një proces transparent për përzgjedhjen e 16 studentëve më të talentuar, të cilët do të angazhohen gjatë një periudhe 3-mujore, duke punuar nga afër me stafin e Bashkisë së Tiranës, për të dorëzuar një propozim të plotë projekti/studimi, i cili do të vihet në zbatim nga njësitë organizative. Faza e dytë e projektit konstaton në seleksionimin e koncept-ideve ku pas përfundimit të peri-

### VLERËSIMI

Vetëm koncept-ide të cilat janë vlerësuar me mbi 50% të totalit të pikëve renditen në listën e shkurtër nga ana e sekretariatit dhe dërgohen për miratim pranë bordit të konkursit. Konkurrimi dhe shpallja e fituesve është faza e fundit e projektit.



kësaj faze do të shqyrtohet plotësisht i kërkesave administrative në dorëzimin e aplikimeve (respektimin e kërkesave për përmbajtjen, mënyrën e dorëzimit, afatin e dorëzimit të koncept-idesë dhe dokumentacionit të kërkuara nga ana e aplikantit). Gjithashtu, do të verifikohen kriteret e vlefshmërisë së aplikimit (mosha e aplikantit, kostoja e propozuar e projektit). Ndërkohë, faza e tretë e projektit përfshin vlerësimin e aplikimeve ku këto të fundit do të vlerësohen nga komiteti vlerësues për njësi organizative. Vetëm koncept-ide të cilat janë vlerësuar me mbi 50% të totalit të pikëve renditen në listën e shkurtër nga ana e sekretariatit dhe dërgohen për miratim pranë bor-

7

16

### GUSHT, AFATI I FUNDIT

Të rinjtë deri në 28 vjeç që kanë përfunduar studimet e larta mund të aplikojnë për të fituar një intership 3-mujor në Bashkinë e Tiranës. Deri në datën 7 gusht të këtij viti të interesuarit do të kenë mundësinë të aplikojnë me një koncept për projekt ose studim.

### FITUES

Faza e parë është aplikimi, ku objektivi i thirrjes për koncept-ide për projekte/studim është të mundësojë një proces transparent për përzgjedhjen e 16 studentëve më të talentuar, të cilët do të angazhohen gjatë një periudhe 3-mujore.

Faksimile e formularëve të aplikimit

Faksimile e formularëve të aplikimit

udhës për dorëzimin e dokumentacionit dhe koncept-idesë, sekretariatit i konkursit do të kryejë verifikimet përfundimtare. Respektivisht gjatë

dit të konkursit. Konkurrimi dhe shpallja e fituesve është faza e fundit e projektit në të cilin bordi i konkursit do të marrë në shqyrtim tabelën përmbledhëse të përgatitur nga komiteti vlerësues dhe

listën e shkurtër të koncept-ideve të përzgjedhura me mbi 50% të totalit pikëve të përgatitur nga ana e Sekretariatit dhe miratim shpalljen e listës. Lista e shkurtër përfundimtare do të bëhet

publike brenda 5 ditëve e më tej sekretariatit do të njoftojë aplikantët e renditur në listën e shkurtër, lidhur me datën, vendin dhe orën e zhvillimit të konkursit.

## HOMAZHET

TIRANE

Familjarë, miq, të afërm, artistë e personalitete të shumta i dhanë sot lamtumirën e fundit artistit të madh të skenës shqiptare, Gaqo Çako. Mjeshtri i madh, Gaqo Çako u nda nga jeta më 1 gusht 2018, në moshën 83-vjeçare. Homazhet në nder tij u zhvilluan në ambientet e Muzeut Kombëtar. Interpretimi i "Traviatës" mbi 280 herë me po të njëjtin pasion do mbetet i ngulitur në mendjet e artdashësve shqiptarë, edhe pse janë të shumta kujtimet dhe këngët që la pas. Ai ishte babai i kantautorit të njohur Pirro Çako. Gaqo Çako lindi më 24 janar 1935. Tenori legjendar, që mban titullin "Artist i Popullit", është i rreshtuar në emrat e mëdhenj të Panteonit të muzikës shqiptare si Ramiz Kovaçi, Mentor Xhemali, etj. Midis viteve 1957 dhe 1961 ai studioi në konservatorin "Çajkovski" të Moskës nën drejtimin e pedagoges Anna Soloviova. Pas kthimit në Shqipëri më 1961, ai u emërua tenor i përhershëm i Teatrit të Operës dhe Baletit të Tiranës, ku këndoi shumë nga rolet e para të repertorit operistik, duke u bërë kështu tenori kryesor për tri dekada me radhë. Përvoja dhe karriera e tij mjaft e pasur në operat "Traviata", "Bohema", "Rigoletto", "Norma" etj., si dhe operat shqiptare "Mrika" e Prenk Jakovës, "Lulja e kujtimit" e Kristo Konos, "Pranvera" e Tish Daisë, "Heroina" e Vangjo Novës, "Skënderbeu" i Prenk Jakovës e "Skënderbeu" i Abdulla Grimcit, "Komisari" i Nikolla Zoraqit, "Zgjimi" i Tonin Harapit, "Toka e jonë" e Pjetër Gacit etj., i dhanë atij një karrierë të shkëlqyer. Mjaft i njohur edhe në skenat italiane, ku ai ka mbaruar konservatorin e 'Santa Cecilia's. Zëri i tij u kthye në objekt kënaqësie kudo që ai u dëgjua e u shfaq, në opera, në televizion, në radio, në salla të mëdha a të vogla koncertesh. Edhe pse vlerën më të madhe ai e pati në interpretimet e roleve operistike, ai u popullarizua nëpërmjet këngës, veçanërisht atyre të Festivaleve të Radios.

## RRËFIMI

Në shkurt të 2015-ës tenori i shquar Gaqo Çako do të bënte një rrëfim të plotë për



Pak histori për njeriun që interpretoi 280 herë me po të njëjtin sukses "Traviatën"

## Përcillet për në banesën e fundit "Artisti i Popullit", Gaqo Çako

*Pengu i tenorit të jashtëzakonshëm, interpretimi i veprave të huaja*



Në foto:  
Presidenti i Republikës në ngushëllimet për familjarët e Gaqo Çakos



Në foto:  
Presidenti i Republikës në homazhet e zhvilluara për Gaqo Çakon

### MESAZHI

Kreu i shtetit u shpreh ngushëllimet e sinqerta familjarëve, miqve dhe të afërmeve të mjeshtrit të skenës lirike, tenorit dhe interpretuesit të këngës lirike shqiptare. Ai mori pjesë në homazhe ndërsa u shpreh: "Nderi i Kombit tonë, mjeshtri i përsosur Gaqo Çako ka lënë gjurmë të pashlyeshme në interpretimet e operave në skenat shqiptare e botërore si dhe ato të këngëve të muzikës së lehtë shqiptare, me ndarjen e tij nga jeta po lë një boshllëk të madh artistik e shpirtëror në trashëgiminë tonë artistike dhe në mes të bashkësisë së artistëve, kolegëve dhe të artdashësve shqiptarë, kudo ku ndodhen.

"Gazeta Shqiptare", ku do të tregonte për jetën e tij personale, vitet e diktaturës, muzikën e familjen. Ai foli për martesën e tij me Luiza Papën, edhe ajo një artiste si dhe marrëdhënien e tij me djalin po artist, Pirro Çako dhe familjen Mula. Gaqo Çako dhe Luiza Papa janë njohur në kur ishin ende veçse adoleshentë. Studionin të dy në Liceun Artistik. Më vonë, Çako u dërgua me studime në Moskë dhe pas tij shkoi edhe Luiza Papa. Dy të rinjtë që deri atëkohë genë miq, panë tek njëri-tjetri dashurinë. Më vonë, kur u kthyen prej andej, në një shtëpi të vogël në Rrugën e Durrësit, ata do të bënin një dasmë të thjeshtë dhe të bukur, ku u këndua 'ditë e natë', siç tregonte artisti për

"GSH". Ai rrefeu pasionin e gruas së tij Luizës për muzikën, por që internimi i dajës ndikoi edhe në "djegien" e karrierës së saj, ndërsa për familjen Mula me të cilën i biri lidhi krushqi vite më parë tregoi se marrëdhëniet ishin shumë të mira. Si peng i Gaqo Çakos mbeti interpretimi i veprave të huaja. "Artisti ka një peng gjithnjë. Unë, në kohën kur isha në kulm të karrierës, kur mund të këndoja, u ndërpreu veprat e huaja. Megjithatë, kam kënduar 30 role në teatër, të huaja dhe shqiptare", tha ai më 2015-ën për "Gazeta Shqiptare", ndërsa përfundoi se në skenë nuk kishte vënë kurrë "Aidën" dhe asnjë të Wagnerit.

PËRSE NA VJEN ERË E KEQE NGA GOJA KUR ËSHTË JASHTË NGROHTË?

# SUMMER

*pages*

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E premte 3 Gusht 2018



**Armela e 'BB' nxjerr të pasmet bombastike**



**Eva Murati lë pa fjalë, seksi në pishinë**

**BULEVARDI POLITIK**



- Deputeti Paulin Sterkaj shërohet plotësisht, ja ku u shfaq
- E rrallë, iu thyen kavanozat me mjaltë, Ramushi i paguan dëmin shitësit
- Kush është ky deputet injorant që nuk di as të shkruajë numrat?
- Gruaja çudit njerëzit, hyn në bankë me qengj



Rrëfëhet regjisori: Ja surprizat për publikun, raporti im me Vera Grabockën

# SOKOL GUGA:

## Sfidat i kam me veten, tregu është i hapur

*"Puna, binom perfekt mes pasionit dhe profesionit"*

**Rrëfhet regjisorin: Ja surprizat për publikun, raporti im me Vera Grabockën**


# Sokol Guga:

## Sfidat i kam me veten, tregu është i hapur

*"Puna, binom perfekt mes pasionit dhe profesionit"*

Egla Xhemali

Fundstatori do jetë i mbushur me surpriza për publikun. Për herë të parë në Shqipëri pritet të vijë njëmbëdhjetë shtete ballkanike në festivalin "Ballkanika Folk", që duket se do jetë një sukses i garantuar. Ne patëm fatin të komunikojmë me producentin dhe regjisorin e këtij eventi kaq të rëndësishëm. Sokol Guga zbuloi për "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare" magjinë e ditëve të festivalit, përgatitjet intensive që kanë nisur që në janar, çmimet që do rrëmben nga shtetet pjesëmarrëse dhe projektet që do pasojnë suksesin në stinë e dimrit. Ai na tregoi për fillimet e tij në televizion, se si e besuan dhe i mbështetën produksionet. Për të, puna është pasioni më i madh dhe objektivi kryesor. Producenti i ka sytë largamës dhe duket se ritmet intensive të punës i kanë sjellë energji, për të pasur vetëm produkte të realizuara dhe të pëlqyera nga audienca. Sokoli pohon se të qenurit krahas Vera Grabockës e ka rritur profesionalisht dhe se ajo ka ndikuar për mirë të ai. Regjisorin është detajist, me shpirtin që kërkon të kapërcejë nga projektet e zakonshme për të sjell produkte që publiku të mahnitet. E kaluara për të nuk harrohet. Ajo shënjon një etapë që Guga i rikthehet herë pas herë, ku shihet realizimet e produksioneve të para. Vera mesa duket do jetë e gjitha e mbushur me impenjime, megjithëse koha më e përshtatshme për të pushuar për të është dimri, që do ta gjejë në Qipro. Sokoli nuk di të ndalet. Për teleshikuesit do ketë surpriza edhe tek spektakli "Krishtlindje në Tiranë" një tjetër event madhështor që e lartëson edhe më punën e tij, ku do ketë të ftuar specialë dhe rikonceptim tërësor të skenografisë. Ne mezi i presim



këto produksione dhe urojmë që Sokoli të ketë vetëm arritje profesionale.

**Ju jeni organizator i festivalit "Ballkanika Folk Festival" në Tiranë. Si po ecin përgatitjet?**

"Ballkanika Folk Festival" vjen për herë të parë në Shqipëri. Është një festival i madh ballkanik me njëmbëdhjetë shtete pjesëmarrëse e duhet theksuar se është risi, pasi vjen për herë të parë në disiplinën e vallës tradicionale. Festivali do të mbahet në datat 21 dhe 22 shtator në një transmetim të drejtpërdrejtë në platformën televizive "Digitalb", ku dymbëdhjetë shtetet konkurruese do të jenë në sfidë për pesë çmime fituese. Sigurisht, përgatitjet kanë kohë që kanë filluar. Ne jemi një staf i madh artistik dhe teknik. Kemi punuar shumë për të sjellë një megafestival ku spektatorët shqiptarë dhe telespektatorët nga ekrani do të njihet me vallen tradicionale ballkanase.

**Sa e vështirë është të merrësh me organizime kaq të mëdha?**

Në fakt mua që i vogël më kanë

pëlqyer organizimet ose masivitetet në stafe nuk më i kam pëlqyer ndonjëherë gjërat e vogla. Unë edhe në jetën e përditshme kur takohem me miqtë e mi kam tendencën që tavolina të jetë plot. Kënaqësia vjen aty ku ka grupe të mëdha shoqërore, siç domosdoshmërisht të mirë dhe me njerëz që i konsideron të afërt. Festivali e mëdha kanë një risk tjetër, pasi është e vështirë të bësh bashkë dy shqiptarë, jo më të bësh pesëdhjetë veta apo njëqind veta në grup megjithatë më jep një satisfaksion shumë të madh. Organizimi i një festivali me përmasa të mëdha apo dhe i çfarëdolloj pune tjetër kërkon përkushtim dhe pasion për punën, për artin, në tërësi edhe për kolegët.

**Ky konsiston ky festival?**

Festivali është konceptuar që të jetë një garë ku do të votohet nga një juri profesioniste ballkanase, që do të thotë që secili shtet do të sjellë një përfaqësues të vetin në jurinë e festivalit, ku nuk ka të drejtë të votojë për vendin e tij. Votimi do të bëhet elektronikisht, që do të thotë secili grup do të votojë në mënyrë elektronike "live" në sallë, pa pasur të drejtën që të votojë për vendin e tij. Grupet do të konkurrojnë për pesë çmime, ku më i madhi prej tyre i përzgjedhur nga organizatorët do të jetë "Çmimi i Lahutës së Artë", që është simboli ballkanas më i vjetër dhe katër çmimet të tjera speciale "Lahuta e Argjendë", "Veshja më e mirë dhe origjinale", "Kërcimtarja/i më i mirë" dhe "Çmimi i produktionit". Çmimi i parë që përmenda do vendoset "live" nga juria në mënyrë elektronike. Në sistemin elektronik të pikëve ne kemi mundësi që të kemi dhe dy fitues, por kjo nuk përbën asnjë problem. E rëndësishme është të kemi një festival dinjitoz, ku të mos kemi dhe keqkuptimet, të jetë votim korrekt



dhe i singërt. Si është fryma e përgjithshme e këtij organizimi?

Përpos dymbëdhjetë shteteve që do të vijin në Shqipëri kemi menduar të sjellim në Shqipëri dhe dy grupe, ansamblin "Kolo" që vjen nga Biel-skobiala në Poloni dhe ansambli arbëreshë "Shqiponjat" që vjen nga Italia. Natyrisht, që nuk do të mungojnë dhe të ftuarit specialë nga Shqipëria, po nuk do të doja të zbuloja surprizat që tani. Mund t'ju them që të ftuar do të jenë gjithashtu një ansambël mirditor, që do të luajnë muzikë me çifteli meqë dhe jemi në vitin e Skënderbeut. Ne po punojmë fort që nga muaji janar për të sjellë një festival artistik me vlera të vërteta, ku do të vijë i qëndisur për të gjithë publikun.

**Ju keni vite që punoni. A keni ndjerë konkurrencë mes kolegësh regjisor?**

Unë nuk ndiej konkurrencë. Nëse i referohemi këtij koncept të them që e ndiej konkurrencën me Sokolin si njeri. Sokoli njeri duhet të punoj shumë që Sokoli artist të eci përpara. Sfidat unë i kam me veten, tregu është i hapur. Gjithsecili ka vendin e tij. Kushdo është i lirë të bëjë festival dhe të prodhojë krijimtarinë e vet artistike.

**Sa krenar jeni për produksionet që mbajnë emrin tuaj?**

Jam shumë krenar. Në fillimet e mia, spektaklet nuk kanë qenë të këtij lloji nivel. Kam punuar në një televizion lokal për të cilin unë jam mirënjohës Gëzim Smaliti, pronar i të "Shijak TV", i cili më hapi dyert e televizionit dhe besoi tek unë. Më pas u rrita profesionalisht dhe mendërisht, punova me Vera Grabockën si asistent i saj. Rrugëtimi im vazhdoi në platformën "Digitalb" me programet me një shkëputje të vetmen në vitin 2015 në "Tring". Jam shumë mirënjohës pronarëve

të mediave e drejtësve të tyre që kanë besuar në produksionet e mia. Jam shumë krenar për punët që kam arritur, sepse gjithçka e kam bërë vet, me pasion dhe përkushtim e shpeshherë unë i shoh dhe i rikthehem.

**Përpos spektakleve dhe eventeve të ndryshme, cila është ajo gjë që u rrëmben kohën?**

Unë mendoj 24 orë për punën. Sapo mbaroj një festival them çfarë do sjell. Unë merrem vetëm me televizionin dhe spektaklin. Më pëlqen shumë puna që bëj dhe u jam mirënjohës disa njerëzve që ma kanë injektuar këtë lojë pasioni.

**Përveç festivalit "Ballkanika Folk Festival" në Tiranë, a do të bëheni pjesë e organizimeve të tjera të mëdha?**

Unë do vit bëj në Shqipëri spektaklin "Krishtlindje në Tiranë". Me të mbaruar festivalin ballkanik ne do të nisim menjëherë punën për edicionin e katërt të këtij spektakli, ku do të ketë mjaft artist të ftuar specialë, që do të vijin nga Franca këtë herë me një orkestër prej pesëdhjetë vetash ku mastro Grid Bici do të dirigjoj dhe do të jetë udhëheqës artistik i spektaklit. Këtë vit është një rikonceptim i skenografisë, mezi po e pres.

**Jeni mërzitur ndonjëherë me punën tuaj?**

Asnjëherë. Mërzitem me individë, të cilët kanë menduar se më kanë penguar. Nuk e di nëse do bëja një profesion tjetër.

**I keni planifikuar pushimet verore? Ku do pushoni?**

Këtë vit nuk ka pushime verore. Jam totalisht i fokusuar te puna me festivalin. Këtë vit do të pushoj ndoshta pas spektaklit "Krishtlindje në Tiranë". Do të udhëtoj drejt Qipros, ku ime motër jeton atje prej vitesh. Ndërrimin e viteve do ta kaloj atje.




## Rezarta Shkurta në "luftë" me erën, i ngre fustanin

Rezarta Shkurta ka publikuar një video në rrjetin social "Instagram", teksa ndodhet në Itali. Tashmë ajo nuk duket më si më parë me flokët brune. Një ndryshim ky mjaft i guximshëm për një femër, që pjesën më të madhe të jetës ka qenë bionde. Në videon që bukurshja ndahu duket lozonjare, në "luftë" me erë që i ngre fustanin. "Merlyn Monroe brune, ka shkruar Rezarta në videon e saj.



## Armela e 'BB' nxjerr të pasmet bombastike

Ndonëse kohët e fundit ajo ka preferuar të qëndrojë larg mediave dhe intervistave të ndryshme. Armela e "Big brother" vazhdon të jetë mjaft e komentuar në "showbizz"-in shqiptar. Bukuroshja ra në sy sapo u bë pjesë e shtëpisë së famshme për pamjen e saj, si dhe për postimet e ndryshme në rrjetet sociale. Së fundmi, Armela ka tërhequr vëmendjen me foton që ka publikuar, ku të pasmet i ka kthyer nga kamera. Ajo ka marrë mjaft komplimente nga ndjekësit.



## Eva Murati lë pa fjalë, seksi në pishinë

Ajo është një nga moderatoret dhe modelet më të dashura të momentit. Gjatë ditës së djeshme, bukurshja Eva Murati ka publikuar në rrjetet sociale disa foto bardh e zi, ku shfaqet në pishinë me seksi dhe provokuese se asnjëherë. Ajo ka pozuar me bikini, ku ka ekspozuar format e saj trupore të kuruara. Mesa duket, moderatorja po i shijon pafund këto ditë të nxehta..



## Luana Vjollca përvëluese, ja çfarë shkruan Krenari

Në media historia e tyre është ndër më të komentuarat. Mes fakteve dyshuese dhe të vërtetës, ka ende një hendek të madh për sa kohë që vetë protagonistët nuk kanë folur qartë për raportin mes tyre. Por, fotografët i kanë fiksuar në aparatet e tyre jo pak herë së bashku, ndërsa komentet që ai i bën Luana Vjollcës shpesh në rrjetet sociale e përforcojnë edhe më shumë idenë se mes të dyve mund të ketë një shkëndijë dashurie. Kështu, ka qenë Luana Vjollca e cila ka postuar ditën e djeshme një video nga ku "ndizte" motorët për performancën e mbrëmjes në Ulqin. Këtë sezon veror, ajo duket se po e kalon mes pushimeve dhe angazhimeve në muzikë, ku prezantuesja simpatike po shfaqet në evente dhe aktivitete të ndryshme. 'Look'-u i saj bëri që një lumë komentesh të vërshonin në videon e postuar, por ndër të tjerë dalloj ai i Krenarit, i cili i shkroi: "Dikush të thërrasë zjarrfikësen". Përgjigja e Luanës?! "Thirri ti", ndërsa e shoqëroi edhe me disa buzëqeshje.



**M**eqenëse tani temperaturat janë rritur, ne kemi filluar më shumë të djersitemi dhe kështu të ndihemi jo këndshëm kur gjurmët e djersës shfaqen në rroba. Jo vetëm që luftoni me djersitjen, por mund t'ju shfaqet edhe erë e keqe si e djersës, ashtu edhe e gojës. Shfaqje a erës së pakëndshme nuk vjen vetëm për shkak të higjienës së keqe, por edhe për shkak të motit. Ekspertët thonë që kjo është pasojë e dehidratimit. Moti i ngrohtë, siç e dimë, shkakton djersitjen dhe sa më shumë që djersitemi, aq më shumë dehidratohemi. Kur jeni të dehidratuar, goja juaj bëhet e thatë, e ngjyeshme dhe pa pështymë. Thartira në gojë nuk është e neutralizuar dhe qelizat e vdekura ngjiten në mishin e dhëmbëve, gjuhë dhe faqe. Për këtë shkak nuk ka pështymë që të pastrojë këto qeliza, ato fillojnë të prishen dhe të shkaktojnë erë të keqe. Goja e thatë mund të shtojë edhe rrezikun nga kariesit dhe infeksionet në gojë. Zgjidhja më e mirë është që të pini lëngje të mjaftueshme, posaçërisht ujë dhe t'i kushtoni kujdes higjienës së gojës. Mbani higjienën furçë të përshtatshme, me pastë për dhëmbë dhe lëng për gojë. Shprehitë tona në ushqim gjatë verës gjithashtu kanë ndikim në atë që a do të kemi erë të pakëndshme. Pijet e gazuara, mishi i skarës, ëmbëlsirat dhe pijet e ëmbla bëjnë që goja të jetë e mbushur me baktere. Për ta shmangur erën e keqe lani dhëmbët së paku dy herë në ditë, pini më shumë ujë, zvogëloni pirjen e duhanit dhe shmangni alkoolin dhe kafeinën. Shmangni ushqimet që krijojnë erë të pakëndshme dhe pas konsumimit të ëmbëlsirave apo të ushqimit të aromatizuar patjetër lani dhëmbët apo përtypni çamçakëz pa sheqer.



## Përse na vjen erë e keqe nga goja kur është jashtë ngrohtë?





## Deputeti Paulin Sterkaj shërohet plotësisht, ja ku ushfaq

Dy muaj më parë kryeministri Edi Rama bëri të ditur se deputeti i Shkodrës, Paulin Sterkaj po luftonte me jetën, pasi po kalonte një provë të vështirë shëndetësore. "Miku ynë Paulin Sterkaj po kalon një provë të vështirë pas një befasi shëndetësore, të cilën lutemi ta përballojë si kampioni që kemi njohur gjithnjë, qysh në rininë e hershme kur ngrinte peshe zemrat e sportdashësve brenda e jashtë vendit. Forca miki! Jemi të gjithë me ty", njoftoi pa dhënë shumë detaje mbi problemin e rëndë shëndetësor me të cilin po përballlet zoti Sterkaj. Pas ndërhyrjes në kohë të mjekëve, socialisti e ka mposhtur këtë sfidë për "jetë a vdekje", duke e kaluar goditjen që pësoi nga ishemia. Tashmë duket qartë se ajo befasi është tejkaluar dhe deputeti i Shkodrës i është rikthyer aktivitetit të përditshëm, por edhe agjendës së tij politike. Sterkaj u shfaq dje në zonën e tij elektorale, në Malësinë e Madhe, ku mori pjesë në inaugurimin e burgut të ri të Reçit. Ai është anëtar i Komisionit parlamentar të Sigurisë dhe kishte një ftesë për këtë inaugurim. Më poshtë fotoja e postuar nga "eeteimes.al".



## E rrallë, iu thyen kavanozat me mjalte, Ramushi i paguan dëmin shitësit

Në sheshin "Nëna Terezë" në Prishtinë ekziston edhe një kënd ku prodhuesit vendorë sheshin perime dhe gjëra të tjera ushqimore. Por diçka e dhimbshme për njërin prej këtyre prodhuesve ndodhi dje. Era e fortë ka rrëzuar të gjithë kavanozat e mjalit duke i thyer ato. Për këtë shitës të mjalit, zyra e kryeministrit të Kosovës ka shprehur vullnetin t'ia paguajë dëmin përmes linjave të caktuara buxhetore.



# BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊

## Kush është ky deputet injorant që nuk di as të shkruajë numrat?

Një deputet i Kuvendit të Shqipërisë është aq injorant sa nuk di të shkruajë e të plotësojë deklaratën e pasurisë. Një deklaratë e tillë pasurie, në të cilën nuk përputhet asgjë mes shifrave dhe asaj që shkruhet pas tyre është publikuar nga Afrim Krasniqi. Në deklaratë, deputeti shkruan se ka blerë një makinë 400 000 leke, ndërsa krah kësaj shifre shkruan "gjashtëqind mijë lekë". Nëse do të kalonte në veting, ky deputet do të ishte i shkarkuar, pasi asgjë nuk përputhet.

Prirësit / pasuritë dhe borxhi / krijimet	Vlera në shifra dhe në %	Pjesë në %
DEPUTETI Afrim Krasniqi Prona: Apt 85m2 në Burim i krijimit: pronë e trashëguar nga familja	5.000.000 Lek (pese milione leke)	100%
Makine: Chrysler Voyager Borxhi i krijimit: w ardhura nga paga dhe kamnet	400.000 Lek (gjashtëqind mijë Lekë)	100%
Depozite kamimesh ne Raiffeisenbank	6.500.000 Lek (6 milione leke)	100%
Depozite kamimesh ne Raiffeisenbank ne Titine	1132454 Lek (nje milion e gjashtëqind mijë leke) + 5.900 EURO	100%

"Ja ku ndodhet vetë politikal! ...Shikoni deklaratën, të cilën e kemi përzgjedhur si simbol i distancës së thellë midis asaj që politika bën dhe asaj që kërkon nga të tjerët. Deklarata ka disa gabime gramatikore në gjuhën shqipe (ia falim edhe sepse ka kolegë të tij në parlament që janë shumë më keq në këtë pikë), por në përkthimin e shifrave në fjalë ka lexim ekstremisht të ndryshëm të pasurisë së tij. Vetë Kuvendi ka Kod Sjelljeje, ka struktura monitorimi. Vetë partia e tij ka kod sjelljeje e struktura monitorimi, por as njeri, as tjetra, nuk kanë bërë asgjë, as detyrimet formale që rrjedhin nga këto akte ligjore/statutore", shkroi dje Krasniqi.

## Gruaja çudit njerëzit, hyn në bankë me qengj

Një grua i ka çuditur punonjësit e bankës kur brenda saj ka hyrë me një qengj të vogël. Muesirja hyri në sportel pa të keq me qengjin që e shoqëronte, të cilin i kishte vendosur edhe një pamper që të mos bënte pis ambientin, raporton "Albeu.com". Qengji nuk iu nda asnjë sekondë asaj deri sa mbaroi punë për të dalë më pas jashtë. Ngjarja ka ndodhur në Konia të Turqisë dhe historia e Muesires me qengjin i ka prekur të gjithë, pasi ajo e gjeti kafshën e gjorë të plagosur në mes të rrugës. Pasi kërkoi disa orë për pronarin duke mos e gjetur, ajo e mori dhe e kuroi në shtëpi. Tashmë qengji gëzon shëndet të plotë dhe e shoqëron pronaren e re në çdo hap.







Opinion i Ditës

# Fundi i një koncesioni dhe fillimi i reagimit institucional

Nga Prof. Asc. Dr. Rezana Konomi\*

(vijon nga faqja 1)

...para se të nënshkruhen kontratat koncesionare, pas nënshkrimit dhe sidomos për sjelljen e koncesionarit gjatë vazhdimet të ushtrimit të së drejtës ekskluzive. Për këtë arsye nuk dëshiroj të bie në përsëritje. Nëse do të monitoronim me kujdes çdo shërbim që është koncesionuar, ekzistojnë probleme dhe kjo ndoshta është e natyrshme, por panatyrshmëria qëndron në faktin kur këto probleme rëndojnë mbi konsumatorin në mënyrë të paarsyeshme dhe kur kjo sjellje u bëhet e ditur institucioneve përgjegjëse, askush nuk reagon. Këtu fillon problemi shqiptar. Të gjithë bëjnë sikur bëjnë dhe asgjë nuk ndodh. Ata që duhet të dëgjojnë dhe reagojnë, bëjnë sikur nuk dëgjojnë, të tjerët (shoqëri civile, grupe aktivistësh apo institucione të ndryshme) që konstatojnë, bërtasin, rekomandojnë, asnjë nuk ua vë veshin dhe secili në stanin e vet tund dybekun.

Por po ndalëm te koncesioni i aeroportit të Rinasit, për të disatën herë, pasi zhvillimet e fundit, reagimet e disa organeve shtetërore, më lanë të kuptoj se deri tani gjithçka është thënë dhe është bërë lidhur me këtë koncesion paska shkuar në vesh të shurdhët. Kush dhe pse u kujtuan pas kaq kohësh të pajtohen me shqetësimin se koncesionari i Rinasit paska biletat më të shtrenjta se çdo aeroport tjetër në rajon dhe më gjerë?

Padyshim që marrëveshja për ndërtimin dhe menaxhimin e aeroportit ndërkombëtar të Rinasit, e cila nisi zbatimin në prill 2005 me afat 20-vjeçar shënoi një zhvillim, pozitiv sepse më në fund shqiptarëve dhe të gjithë përdoruesve të kësaj porte të vetme ajrore do t'u ofrohej një shërbim cilësor me standarde europiane. Përfitimet nga ky investim kanë qenë të shumfështa dhe të pamohueshme. Por, a mund të justifikohet rritja e cilësisë së shërbimit me kosto kaq të larta për konsumatorët?

Pikërisht në analizë të sjelljes së këtij koncesioni Autoriteti i Konkurrencës, si një institucion i pavarur publik, i vetmi që monitoron kushtet e tregut, sjelljen e operatorëve, para dhe pas dhënies së të drejtës ekskluzive, ka dalë me disa vendimmarrje, të cilave çuditërisht vetëm ditët e fundit po u bëhet jehonë, megjithëse ato datojnë shumë më herët. Janë dyshime dhe hamendësi, të cilat nuk mund të kalojnë pa vëmendje, sepse kjo heshetje e zgjatur dhe ky zgjim i vonuar duhet të këtë dhe disa përgjegjës, të cilët me veprimet dhe mosveprimet e tyre nga padijenja apo dënime dhe kamuflluar, kanë sjellë pasojë në dëm të interesit publik dhe kanë rënduar padrejtësisht xhepat e konsumatorëve.



Në media, kohët e fundit po flitet çdo ditë për çmimet e larta të biletave me të cilat operohet në aeroportin e vetëm ndërkombëtar të Rinasit. Kjo është një e vërtetë e hidhur, që gjithkush e di dhe e ka provuar. Por nuk mund të rri pa përmendur habinë që ndjeva kur pashë reagimin e deputetëve se çmimet paskëshin qenë shumë të shtrenjta dhe pikërisht këta deputetë që rrinë më shumë në ajër se nëpër zyrë, vetëm tani e kuptuan se sa shtrenjtë paguajnë shqiptarët kur përdorin këtë aeroport. Është qesharake dhe në të njëjtën kohë tallëse dhe fyese. Si është e mundur që të paktën deputetët, të cilët janë mjaft mirë të informuar për çdo vendimmarrje të Autoritetit të Aviacionit Civil apo Autoritetit të Konkurrencës, lidhur me analizën dhe rekomandimet që kanë adresuar kohë pas kohë për këtë koncesion të bëjnë rolin e të paditurit dhe të çuditurit. Ku kanë qenë këta deputetë kur ky Autoritet paraqiste çdo vit raportin vjetor dhe shqetësimi për këtë koncesion ka qenë prezent në çdo vit, sepse edhe vendimmarrjet lidhur me të kanë qenë sistematike. Ah! po, ndoshta në ato ditë, kanë qenë duke udhëtuar me ato biletat e shtrenjta, por që asnjëherë nuk e dinin sa kushtonin derisa sot e dëgjuan dhe e kuptuan, se ndoshta mund të këtë sjellje abuzive të këtij koncesioni. Por, kusuri nuk është vetëm i koncesionarit, i cili gjeti shesh dhe bëri përshesh. Madje, besoj edhe ai vetë është po kaq i çuditur se çfarë ka

ndodhur pikërisht tani që pala shqiptare po reagon për disa fakte, të cilat kanë ekzistuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit! Roli inekzistent i palës shqiptare ka bërë që koncesionari të ofrojë tarifa për shërbimet tepër të larta, të paaudituar, të parishikuara për përdoruesit të gjata kohore dhe kjo është reflektuar në çmimi i biletave. Sipas kontratës së koncesionit, në pikën 19 përcaktohen pagesat për shërbimet e aeroportit, vlerësimi periodik i tyre, rishikimi në periudha të ndërmjetme i pjesës së miratuar të kostonë së operimit dhe rishikimi i pavarur nëse mendohet se është e nevojshme. Tarifat për shërbimet e ofruara nga TIA përgatitën nga shoqëria koncesionare dhe miratohen nga Organi Shtetëror i Autorizuar. Në vijim në pikën 19.2 germa a përcaktohet se: "Organi i Autorizuar Shtetëror dhe shoqëria do të rishikojnë pagesat për shërbimet e aeroportit çdo tri vite...". Nga vëzhgimet rezultuan se rishikimi i parë dhe i fundit është në vitin 2007. Ky problem, përveç të tjerave, gjatë procesit hetimor është konstatuar nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili i ka dërguar rekomandim ministrisë përgjegjëse, Entit Rregullator, si dhe Kuvendit të Shqipërisë, por fatkeqësisht asnjëherë nuk pati as më të voglin reagim. Kur shteti nuk përfill, nuk dëgjon institucionet e veta, nuk zbaton vendimet e tyre, çfarë mund të pretendojë shoqëria civile se do t'i dëgjohej zëri dhe shqetësimi qytetar?! Në këtë vazhde edhe dilema të flasësh apo mos

flasësh, të shkruash apo jo, shkon në favor të kësaj të dytës. Nëpër edicione lajmesh transmetohen çdo ditë problemi i çmimeve të larta të biletave, apo mungesa e një metodologjie dhe rregullor të miratuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar, i cili së bashku me Entin Rregullator e ka për detyrë të monitorojë një treg me situatë monopolit dhe të ndikojë në rregullimin e tarifave, duke i orientuar ato drejt kostonë, me qëllim shmangien e abuzimit me pozitën dominuese në këtë treg. Por, të gjitha këto teori veprimesh e mosveprimesh të institucioneve shtetërore, dukë luajtur pingpong nuk u duhen shqiptarëve apo kujtdo që përdor këtë shërbim. Moskryerja e detyrave nga organet dhe institucionet përgjegjëse nuk është çështja jonë. Papërgjegjshmëria dhe kultura e mosndëshkimit duhet të fillojë nga vetë pushtetarët për të dhënë modelin së kushdo që abuzon, nuk kryen detyrën për të cilën paguhet nga taksat tona, duhet të ndëshkohet dhe të mbajë përgjegjësi. Zinxhiri i organeve përgjegjëse për koncesionin e Rinasit, por jo vetëm për këtë koncesion, të cilët nuk kanë vepruar dhe me dashje kanë lejuar këtë sjellje abuzive është i gjatë. Bazuar në nenin 11/4 të Kodit të Transportit Ajror, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e tarifave dhe praktikave diskriminuese, çmimeve abuzivisht të larta si rezultat i një pozitë dominuese dhe çmimeve

abuzivisht shumë të ulëta. Por, Autoriteti i Aviacionit Civil i miraton tarifën e kompanive të njoftuara në AAC, pa pasur një analizë kostoje apo metodologji për vlerësimin e këtyre tarifave. Çfarë ka bërë ky Autoritet deri sot? Konsiderohet se i ka kryer funksionet e tij? Kush i ka kërkuar llogari për këtë mosveprim, apo heshetje ka qenë marrëveshje e heshtur dhe e parapëlqyer për funksionet dhe drejtuesit përkundrejt epurve. Shqiptarët përsëri të braktisur nga shteti i vet, i cili nuk ushtron asnjë rol rregullator, asnjë balancë midis interesave private dhe atyre publikë, madje shumë më keq se kaq, as që do t'ia dijë se sa shumë rëndon kjo pozitë në jetesën e përditshme të qytetarëve.

Jo më larg se dje, dëgjova se Autoriteti i Konkurrencës i ka kërkuar Kuvendit që të ndërhyjë për të zbatuar rekomandimet e tij lidhur me koncesionin e Rinasit. Nuk mund të mos çuditësia sërish. Reagim i vonuar, pse tani, çfarë ka ndryshua?! Autoriteti i Konkurrencës vendimmarrjen e tij të parë e ka në vitin 2014 dhe në vijim ka pasur disa të tilla, ndërkohë që çdo vit ka raportuar në Kuvend për problematikat, për rekomandimet e pazbatuara, por asnjëherë nuk ka këmbëngulur publikisht si tani. Këtu kuptova pavarësinë e institucioneve tona të pavarura. Kur Kuvendi reagon, kur deputetët bashkohen me shqetësimin qytetar, atëherë dhe organet e shtetit dhe institucionet fillojnë të zgohjen, të bashkojnë zërin me maxhorancën (cilado qoftë ajo në pushtet) dhe të tregojnë rolin e kompetencat e tyre ligjore.

Nëse do të jemi të vëmendshëm sa herë ka reagime të tilla ku zëri i politikës dhe i institucioneve fillon të dëgohet, do kuptojmë pse ndodhin në mënyrë ciklike këto reagime, ndërkohë që problemet dhe shqetësimet kanë qenë dhe mbeten aty të pagzjidhura për vite të tëra. Para një ose dy vitesh u fol për negociatën me koncesionarin për hapjen e aeroportit të Kukësit, më pas ministri përgjegjës deklaroi publikisht se për 3 muaj situata do ndryshojë, së fundi është përfolur për hapjen e një aeroportit në jug të vendit. Por është fakt i ditur që kushtet e kontratës koncesionare nuk mund të ndryshojë, nëse të dyja palët nuk dakordësojnë dhe të gjitha këto deklarime fluskash sapuni bëhet në sezon vëre, kur piku i turistëve dhe i hyrje-daljeve rritet në mënyrë të ndjeshme. Ky është pikërisht opiumi që na trullon dhe në gjumë vetëdijën, na vë në gjumë të pritit deklarimin dhe çudinë që pason natyrisht verës tjetër. Dhe në këtë mënyrë, fatit të këtij koncesioni po i vjen fundi dhe zëri ynë për të reaguar sa vjen dhe meket... Dekane e Fakultetit Drejtësisë KU "LUARASI"\*

Opinioni i Ditës

Teatri dhe ekonomia simbolike

Nga Andi Tepelena

(vijon nga faqja 1)

...Kushtetutës së vendit, tek injorimi i ndjeshmërisë dhe simboleve kombëtare. Kjo që po ndodh me Teatrin nga ana e Rilindjes dhe kryeministrit është deformim i rëndë i demokracisë. Por në këtë shkrim do orvatem ta trajtoj çështjen e Teatrit nga një këndvështrim tjetër. Në një nga shkrimet më të famshme të Pierre Bourdie, një nga sociologët dhe intelektualët më enigmatikë të mesit të shekullit të kaluar, i cili trajton 'logjikën e ekonomisë simbolike', në shkrimin e famshëm mbi krijimin e besimit, Bourdie orvatet të aplikojë këtë model në ekonominë simbolike të artit bashkëkohor duke e nisur atë nga korrelacioni ekzistues midis vlerës estetike të artit bashkëkohor me ekonominë simbolike. Kështu, Bourdie identifikon figurën e "Nouveau riche", që do të posedojë me çdo kusht një vepër arti, si shenjë prestigji dhe nuk pyet fare për koston që ajo realisht mund të ketë. Ky blerës i ri është gati të paguajë një çmim afektiv që është jashtë fuqisë blerëse të tregut, por që në fakt jo vetëm përdor tregun, por e përcakton atë duke rritur vlerën e saj simbolike dhe si rrjedhim çmimin e veprës. Por të vijmë tek çështja e Teatrit, ku edhe për këtë rast mund të aplikohen konceptet e Bourdie. Kështu, Rama tenton të bëhet pjesë e tregut të artit bashkëkohor duke shfrytëzuar pushtetin politik. Ai përdor hapësirën Cod dhe Galerinë Kombëtare për të promovuar veten dhe miqtë e tij. Duke i pasur nën kontrollin e tij të dyja këto institucione, ai përdor operacione marketingu për të rritur artificialisht vlerën monetare në tregun e artit të kontrolluar nga galeri të fuqishme, shpesh me lidhje okulte me kryeministrin, me qëllim përcaktimin e vlerës së veprave të artit të tij dhe miqtë të tij. Me anë të kësaj forme kontrolli dhe influencës pushtet, Rama falë ushtrimit të funksionit të tij, përdor asetet publike për të promovuar veten dhe miqtë e tij në vitrinat më të rëndësishme të artit dhe arkitekturës. Dë gjitha këto operacione marketingu duket të përdoren, në saj të pushtetit të tij pakufi, për të pasur një "status symbol", ku qëllimi mbetet vetëm një: rritja artificiale e vlerave estetike për të fryrë shifrat e veprave të tij dhe miqtë ndaj klientëve ndërkombëtarë. Por etja për të rritur "status symbol" e tij nuk ndalet vetëm në sa më lartë. Ai, tashmë kërkon të përdorë edhe pronat publike ku të shtrijë influencën e tij. Bourdieu e ka analizuar konceptin e Ekonomisë Simbolike edhe për tregun e pasurive të paluajtshme vlera monetare e të cilin varet shumë nga vendime apo abuzimi me pushtetin dhe bërja e ligjeve favorizuese në favor të një grupi klientësh dhe në dem të shumicës, siç është dhe ky për Teatrin Kombëtar. Mjafton këtu të përmendim në formë shembulli konkret, projektimin dhe realizimin e stadiumit apo nëpërmjet PPP-s, nën justifikimin se shteti nuk ka para, duke komisionuar studio arkitekturore nën kontrollin e tij, për të kuptuar se qëllimi final shndërrohet në atë të prurjes në mënyrë direkte të ardhurash të shumta në xhepin e klientëve të tij vendës dhe ndërkombëtarë. Dhe, përnjëmend, kjo duket



të jetë mënyra më e mirë për të justifikuar pasurinë "që përfitet" edhe nga raporte të ndryshme matëse të nivelit të korrupsionit në Shqipëri, ku shifrat marramendëse në pronësi të individëve autokratë në vende me nivel të lartë korrupsioni, ku rriten në mënyrë artificiale tregun e shitjeve nëpërmjet mekanizmash spekulativë të projekteve me kulla, qendra tregtare të destinuara të destinuara të vdesin që në lindje, me pasojë shkatërrimin e mjedisit dhe historinë e qytetit, duke krijuar kufijtë brenda qytetit, ndarje të bazuara në klasat sociale, si një formë "moderne" aparteid urban. Vepra "How to Build a Fairer City", një manifest i arkitekteve europiane (Ewald Engelen, Sukhdev Johal, Angeli Salento dhe Karel Williams) vendos në kundërshtim dy vizione të ndryshme të së ardhmes së qytetit: e para vizioni ekonomik neoliberal, i thjeshtësuar në pas në versionin e Edward Glaeser, "Triumph of the City". Në këtë model jepet ideja e një perspektive që duhet të vijë përmes urbanizimit dhe konkurrencës midis qyteteve, të përbërë nga kulla gjithmonë e më të larta; arkitekturë befafuesë, hotele të shtrenjta, qendra tregtare që krijojnë në dukje një brand në ndryshim të vazhdueshëm. Ky model na paraqitet kine si motor kreativiteti dhe suksesit, pra lumturie. Modeli tjetër i kundërt i "How to Build a Fairer City" është ai i një ndryshimi radikal perspektive. Fokusit në këtë model është ndikimi kulturor në imagjinatën kolektive, sjellja politike e përgjegjshme në aspektin e praktikave të qeverisjes duke braktisur garën e gendrave 'copy&paste' moderne duke synuar përtej, ekzaktesisht, tek karakteristikat specifike të secilit qytet dhe mbi potencialin krijues që qytetarët mund të çlirojnë nga vetëdija dhe nga kujtesa kulturore. Pra, krijimi i një modeli qyteti në gjendje të shpërndajë brenda vetes vlera njerëzore, të mira dhe shërbime që garantojnë jetë dinjtoze

të qytetarëve të vet. Një argument si ky nuk u përket vetëm specialistëve të zhvillimeve urbane, ekonomisë dhe arkitekturës. I përket komunitetit të qytetarëve dhe si e tillë, politikës si një instrument që synon interesin e përgjithshëm të komunitetit. Njëloj siç po vepron me ekspozitat e veta, duke shfrytëzuar karrigen e kryeministrit, për të rritur "status symbol" në tregun ndërkombëtar të artit bashkëkohor. Rama përdor kullat në pronat publike në qendër të Tiranës, pikërisht në funksion të ekonomisë simbolike të tregut mobiluar ndërkombëtar. Institucionet tërësisht nën kontrollin e tij sillen në mënyrë të atillë, ku interesi privat i individëve mbizotëron lehtësisht mbi atë publik. Gjendim përpara një skenari tipik ku qeveritë autokratë bëjnë një rritje fikitive të shifrave ekonomike me anë të ingranazhit të parave të pista, bëjnë ligje të posaçme apo favorizuese për klientët e tyre, intimidojnë shoqërinë civile dhe mediat, dhe në fund nxjerrin dekrete për të mbyllur teatrin, si tempuj të fjalës së lire, shkatërrjnë trashëgiminë kulturore, me justifikimin e një zhvillimi modern. Busulla orientimi për qeverisjet e përgjegjshme duhet të jenë Kushtetutat dhe ligjet e vendeve perëndimore, që në çështje të kujtesës së qytetit dhe trashëgiminë kulturore vendosin të drejtën e qytetarëve për të vendosur. Mjafton të citoj këtu një nen të Kushtetutës italiane, ku thuhet: "Përmes ligjit themelart të shtetit, bashkësia e qytetarëve, si burim i ligjeve dhe posedues i të drejtave, identifikon në trashëgiminë historike-artistike një element thelbësor të demokracisë, të barazisë, të lirisë. Një privilegj i qytetarisë". Në Kushtetutën gjermane fjala kyçe 'Denkmal' (monument) përshin art, histori në një lidhje unitare të bazuar të kujtesës. Ekziston rreziku real që në këto kushte, një ekonomi spekulative e bazuar në "afera - klienteliste të personalizuara", që nuk respekton di-

mensionin qytetar; të plasë si fluskë sapuni. Ndaj këto ditë lipset më shumë se kurrë dhe me urgjencë një rol aktiv i qytetarëve, të cilët nëpërmjet lirisë së shprehjes të demokratizojnë hapësirat publike, të ushtrojnë qytetarinë, të artikulojnë pasojat kulturore sociale të tjetërsimit të pronës publike nga një grusht "artefesh-demagogjiko-propagandistike" në dem të shumicës, të parandalojnë që Tiranën, tashmë e shpërfytyruar në planin urban, të shkatërrohet akoma më shumë dhe të shndërrohet në një qytet konfliktual si pasojë e spekulimeve arkitekturore. Ky është një problem politik, i cili do të kushtëzojë jetët tona më shumë se çdo lloj ligji. Vetëm mbrojtja e trashëgimisë kulturore, kujtesës kolektive dhe garantimi i të drejtave qytetarëve jep një rrugëzgjidhje. Sot, mbrojtja e Teatrit dhe pronës publike, aty ku Teatri "banon", bëhet me imperative se kurrë për tju përgjigjur parimeve të barazisë sociale, drejtësisë dhe demokracisë. Duke e mbyllur me shprehjen e presidentit amerikan, Theodore Roosevelt: "Duhet të ndalojmë një minorancë pa parime të shkatërronjë një trashëgimi, që u përket brezave që do të vijjnë. Lëvizjet për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe burimeve natyrore janë thelbësisht demokratike në frymë, qëllim dhe mjet". Mendoj se ka ardhur koha që ne, qytetarë e Tiranës, në zgjedhjet e ardhshme të zgjedhim pikërisht ata kandidatë që do të rikuperojnë dimensionin njerëzor dhe komunitar të qytetarisë, do të respektojnë mjedisin dhe trashëgiminë historike-kulturore. Institucionet e përgjegjshme kanë detyrimin të bëjnë ligje me koncepte demokratike, që nuk sjellin padrejtësi sociale. Roli i institucioneve është të sjellë në qendër problemet njerëzore dhe sociale në kundërshtim me spekulimet mobilare në emër të "gjoja" zhvillimit modern të Tiranës.

Kurator arti

HOROSKOPI

DASHI

Stresi mund t'u shkaktojë disa probleme të vogla shëndetësore. Qëndroni sa më pranë familjarëve dhe miqtë për t'u relaksuar. Përpiguni të kurseni para dhe të mos kryeni shpenzime të panevojshme. Sot mund të mëmi një ligj shumë të mirë. Sa i përket anës romantike, do të kenë një ditë shumë të mirë dhe të mbushur plot me emocione.

DEMI

Bëni kujdes kur të kaloni rrugën, pasi mund të bëheni pjesë e një aksidenti për shkak të neglizhencës së dikujt. Ka gjasa që sot të zhgënjeheni nga miqtë tuaj, pasi nuk do të jenë pranë jush në një moment mjaft të vështirë. Mos u përfshini në një çështje që nuk ju takon, pasi do të kenë telashe.

BINJAKET

Seni jua i humori do të ndihmojë dikë të kuptojë se lumuria nuk varet vetëm tek pronësitë, por ndodhet brenda jush. Kaloni më shumë kohë me familjen. Kujdesuni sa më shumë për partnerin/partneren dhe vlerësojeni atë. Sa u përket çifteve të martuar, do të jetë një ditë shumë e mirë.

GAFORJA

Besimi tek vetja dhe energjia do të jenë në nivelin më të lartë gjatë ditës së sotme. Të ardhurat financiare do të rriten dhe ka gjasa të kenë disa firme të papitura. Dikush mund t'ju jua vëzhgom gjatë gjithë kohës dhe ju shet si një model për jetën e tij, duke ndikuar kështu edhe në rritjen e reputacionit tuaj.

LUANI

Disa mendime të padëshiruara do t'ju shqetësojnë gjatë ditës së sotme. Përpiguni të kryeni disa ushtrime fizike, në mënyrë që të ndihni të çliuar. Sa i përket anës romantike, nuk do të jetë dita juaj për shkak të shëndetit të partnerit/partneres suaj. Do të kaloni një ditë të mirë me miqtë, të cilët do të kërkojnë edhe kështu para jush.

VIRGJERESHA

Niveli i energjisë do të jetë i lartë dhe duhet ta përdorni atë për të përfunduar disa detyra. Mëmi mendimin e familjarëve tuaj para se të mëmi një vendim të rëndësishëm. Krijoni harmoni në familje që të kenë rezultate të mira. Keni mundësi të arrini shumë, kështu që ju e mos humbini asnjë shans që ju del përpara.

PESHORJA

Bëni kujdes sot me sjelljen tuaj! Mos ndërhyini me shumë sëç duhet në punët e partneres/partnerit tuaj, pasi kjo do të shkaktojë vetëm probleme. Qëndroni larg thashethemeve. Ka gjasa që sot t'ju bëjnë një surprizë shumë të mirë. Do të kaloni një ditë të mirë me miqtë, një person shumë interesant.

AKREPI

Sot do të kenë disa probleme shëndetësore. Zbuloni mundësi të reja investimi dhe studijoni mirë ato. Ka gjasa të njihni me disa miq të rinj. Sa i përket anës romantike, do të jetë një ditë e komplikuar. Sot do të zbuloni se një person që ju e konsideroni armik, realisht është një mik shumë i mirë.

SHIGJETARI

Partner/partnerja juaj do të ndihet shumë mirë sot dhe këtë gjendje emocionale do t'ju përcëllojë edhe juve. Në shtabi do të kenë një atmosferë festive, e cila do të lehtësojë tensionin e krijuar më parë. Kontakti me persona të rëndësishëm do t'ju sjellë rezultate të mira. Përpiguni të shmangni kritikë për çështje të vogla.

BRICJAPI

Duhet paqetë të shmangni stresin. Përpiguni të kaloni sa më shumë momente të këndshme me miqtë tuaj. Shëndeti i partneres/partnerit juaj mund t'ju shkaktojë stres. Temperamenti juaj mund t'ju fusë në disa telashe gjatë ditës së sotme në punë.

UJORI

Përdorni energjitë siç duhet. Ka gjasa që sot ta teproni me shpenzimet, por kjo nuk do të ndikojë mirë në planet tuaja. Qëndroni larg personave që përpigun t'ju mësojnë zakone aspak të mira. Sa i përket anës romantike, do të jetë një ditë shumë e veçantë.

PESHQIT

Kaloni më shumë kohë me familjet tuaj, pasi do t'ju ndihmojë shumë të çlirohni nga stresi. Sot mund t'ju vijë një ofertë e mirë punë dhe ka mundësi që të ndryshoni vendin e punës, madje edhe lëshoni përkatëse për të cilin punoni. Zgjidhni fjalë kur fitoni dhe mos u notoni gjatë bisedës me persona të rëndësishëm. Partneri/partnerja juaj do t'ju bëjë të ndihni shumë mirë gjatë ditës së sotme.

**30 shtatori, pritet votimi i njerëzve dhe mbështetja e opozitës**

**Referendumi për marrëveshjen mbi emrin e Maqedonisë, Matthew Palmer: Moment historik**

Matthew Palmer, zëvendës-njihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euro-Azinë, tha para dy ditësh në Shkup se referendumi për marrëveshjen mbi emrin e Maqedonisë, është një moment historik për vendin. Zoti Palmer ndodhet për vizitë në Shkup, ku po takohet me zyrtarë të lartë shtetërorë dhe politikë, për të shprehur mbështetjen e shteteve të Bashkuara për Marrëveshjen e Prespës me Greqinë për çështjen e emrit të Maqedonisë dhe për afrimin e mëtejshëm të saj drejt anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Zoti Palmer u prit nga presidenti Gjorge Ivanov, ndërsa zhvilloi takime edhe me kryetarin e partisë opozitare

VMRO-DPMNE, Hristijan Mickovski, me atë të Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti dhe me kryeministrin maqedonas Zoran Zaev. Vizita e tij ndodhi në një kohë kur autoritetet qeveritare maqedonase po përpiqen të bindin qytetarët për pjesëmarrje në referendumin e 30 shtatorit ku duhet të zyrtarizohet ndryshimi i emrit të vendit në "Republika e Maqedonisë së Veriut", për çka kërkohet edhe mbështetja e opozitës maqedonase. "Do t'i japim publikut maqedonas mundësinë për të para-

**MATTHEW PALMER**

"Do t'i japim publikut maqedonas mundësinë për të paraqitur pikëpamjet e veta për marrëveshjen. Ky është me të vërtetë një moment historik për Maqedoninë dhe për Marrëveshjen e Prespës dhe sapo të ratifikohet dhe zbatohet, do të hapen dyert drejt së ardhmes evropiane për Maqedoninë dhe popullin e saj", u shpreh zoti Palmer.

qitur pikëpamjet e tij për marrëveshjen. Shpresojmë që njerëzit do të dalin të votojnë dhe të shprehin vullnetin e tyre dhe këtë ta bëjnë në një atmosferë të lirë nga dez-

formimi apo shkurajimi. Ky është me të vërtetë një moment historik për Maqedoninë dhe për Marrëveshjen e Prespës dhe sapo të ratifikohet dhe zbatohet do të hapen



Matthew Palmer

dyert drejt së ardhmes evropiane për Maqedoninë dhe popullin e saj", u shpreh zoti Palmer. Lidhur me marrëveshjen me Greqinë, presidenti Ivanov, sipas një komunikate nga kabineti i tij, ka theksuar se nuk pranon një marrëveshje "e cila e shkelë kushtetutën dhe rrënon in-

stitucionet shtetërore dhe që shkon në dëm të interesave kombëtare maqedonase". Mathew Palmer ditën e sotme do të marrë pjesë në festimin e festës së lindenit në qytetën e Krushevs, si edhe do të takohet edhe me zyrtarë të tjerë vendorë.

**Shkëmbimi i informacionit mes KE dhe qeverisë së SHBA, rrezikohet "Privacy Shield"**

**Mbrojtja e të dhënave, BE i cakton afat Trumpit: S'po zbatoni marrëveshjen e 2016-ës**

**Zëdhënësja e presidentit: Projektligj brenda shtatorit**

Pra dy vitesh, në 1 gusht 2016 hyri në fuqi marrëveshja informale për shkëmbimin e të dhënave personale midis Komisionit Evropian dhe qeverisë së atëherëshme të SHBA. Marrëveshja me emrin "Privacy shield" (Mbrojtja e sferës private) u mundëson 3500 sipërmarrjeve që marrin pjesë në të SHBA dhe në Bashkimin Evropian që të dërgojnë të dhëna, email dhe fotografi të klientëve të tyre matanë Atlantikut. Komisioni Evropian ankohet se qeveria aktuale amerikane nën Donald Trumpin nuk e zbaton marrëveshjen për "Privacy Shield" dhe rrezikon me këtë mbrojtjen e të dhënave. Komisarja e Drejtësisë e BE, Vera Jourova i ka shkurruar javën e kaluar ministrit amerikan të Tregtisë, Wilbur Ross një letër ankuese duke i dhënë atij afat deri në fund të tetorit. Jourova kritikon ndër të tjera se pala amerikane nuk ka caktuar ende një person të ngarkuar, ku klientët evropianë të mund të drejtohen kur mendohet se kanë të bëjnë me shpërdorim të të dhënave të tyre. Ministri i Tregtisë, Ross përkundrazi, para disa muajsh e kritikoi si të tepruar mbrojtjen e të dhënave në Evropë. Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave që hyri në fuqi në maj rrezikon bizneset e sipërmarrjeve amerikane, u bë e ditur nga ministria e Drejtë-



sisë. Parlamenti Evropian kërkoi në një rezolutë madje që marrëveshja për "Privacy Shield" për shkëmbimin e të dhënave të shfuqizohet që në 1 shtator dhe të përpunohet. Kryetari i Komisionit të Brendshëm në parlament, Claude Moares tha që në qer-

shor se "Privacy Shield" nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme në kuptimin e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave dhe të Kartës së të Drejtave Bazë. Marrëveshja "Privacy Shield" u mundëson sipërmarrjeve si "Facebook" ose "Google" qasje

në të dhënat dhe në të gjitha përmbajtjet e përdoruesve të tyre në Evropë. Atyre u dëshmohe, pa i kontrolluar më tej, se përcaktimet e tyre për mbrojtjen e të dhënave janë në përputhje me kërkesa evropiane. Nga ana e saj, qeveria amerikane ka pranuar detyrimin që të ketë qasje në të dhënat e "Facebook"-ut etj., vetëm në gjashtë raste të formuluara disi turbull, për t'i analizuar këto të dhëna nga shërbimet e fshehta. Kjo synohet të pengojë një përgjim masiv të përdoruesve evropianë. Veç kësaj, administrata amerikane ka shpallur detyrimin që ta vëzhgojë më mirë mbrojtjen e të dhënave në sipërmarrjet amerikane dhe të ngrejë një instancë për ankesat. Dy vjet më parë,

Gjykata Evropiane e Drejtësisë e shpalli të pavlefshme një rregullore të vitit 2000 të njohur me emrin "Safe Harbour". Paditësi ishte avokati i ri, Max Schrems nga Austria. Ai që mbrojtur në Irlandë, ku e ka për arsye taksash rezidencën evropiane "Facebook"-u, kundër përdorimit të të dhënave të tij në "Facebook". Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kritikoi atëherë se në SHBA nuk ka rregullore të ngjashme për mbrojtjen e të dhënave si në Evropë. Institucionet në SHBA kanë thuar se qasje të pafrenuar nga rregulla në të dhënat e "Facebook"-ut, "Yahoo", "Google" etj. Prandaj marrëveshjet për shkëmbimin e të dhënave janë të mundura vetëm nën kushte

të rrepta. Ndërkohë Schrems është avokat për mbrojtjen e të dhënave dhe aktivist për mbrojtjen e të dhënave. Ai e ka hedhur sërish në gjyq marrëveshjen e re "Privacy Shield" para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Se kur do të merret vendimi për këtë është paqartë. Zëvendës-zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Lindsay Walter bëri të ditur se "administrata e Trumpit do të synojë që të paraqesë një projektligj për mbrojtjen e të dhënave private, i cili të ruajë balancën midis sferës private dhe efikasitetit ekonomik". Kjo do të ndodhë deri në vjeshtë. Për momentin në SHBA nuk ka asnjë ligj federal që të rregullojë mbrojtjen e të dhënave.

**KORSIKË, DALLGA E FORTË NË KANION SHKAKTON PESË TË VDEKUR**

Ditën e djeshme është gjetur trupi i pajetë i një gruaje 22 vjeçe, duke e çuar në pesë, përfshirë një fëmijë, numrin e personave të mbytur nga një dallgë e fortë që përfshiu një kanion në ishullin francez të Korsikës, bëhet e ditur nga burime policore. Trupi i vajzës së re u gjet 150 metra nga zona ku u mbytën katër persona, edhe një fëmijë 7 vjeç, trupat e të cilëve u gjetën të mërkurën. Pesë viktimat e kësaj tragjedie janë një vajzë 7 vjeçe dhe i ati i saj, udhërrëfyesi i kompanisë "Alticanyon", i moshës 36 vjeç, një djalë i ri 26 vjeç dhe një grua e re 22 vjeçe, sipas së njëjtit burim.


**FOTOLAJM**

**SHKURT**

**Sulmuan mbi 120 kompani amerikane, kapet grupi ndërkombëtar i kimit kibernetik**

Hajdutët kibernetikë, të cilët vodhën miliona numra kartash krediti e debiti nga rrjetet më të mëdha komerciale në Shtetet e Bashkuara, kanë përfunduar në pranga, bëjnë me dije autoritetet amerikane. Të arrestuarit janë pjesë e grupit të njohur FIN-7 në Evropën Lindore, të dyshuar për disa sulme kibernetike ndaj më shumë se 120 kompanive amerikane në tre vitet e fundit. Grupi kryente sulme kryesisht në industrinë e restoranteve, lojërave të fatit dhe mikpritjes, sipas prokurorëve. Zyrtarët i identifikuan tre të arrestuarit si shtetasit ukrainas Dmytro Fedorov, 44 vjeç, Fedir Hladyr, 33 vjeç dhe Andrii Kolpakov, 30 vjeç. "Ka qenë një hetim atëgjatë dhe i sofistikuar ndaj një grupi të kimit të organizuar që i kalonte kufijtë e vendeve dhe që e identifikuan përmes ekspertizës së avancuar kibernetike", thotë Jay Tabb, Agjent i posaçëm i FBI-së.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Emri i Monet.
- Një top në rrjetë.
- Carl Edward, që shkroi Contact.
- Qe bukuroshi që u hidhte ferë perëndive.
- Qe era hyjnore e japonezeve.
- Një pjesë e lartësive.
- Muzikanti që... nuk përsëriste.
- Lumë në Rusi.
- Eshhtë i lartë ai i kampionit.
- Kalifi që themeloi Kairon.
- Kështu e quajti Krishti shën Pjetrin.
- Janë në guvë.
- liioni portier.
- Markë makine.
- Ashtu si duhet të përgjigjet fituesi.
- Inicialet e Mann.
- Një parabolë e tenisist.
- Fillojne tatepjetjen.
- Ente Autonome.

- Jean, që solli duhanin në Europë.
  - Mund të jetë dëshmor.
  - Pak stabilitet.
  - Arturo i Brecht.
  - Një pjesë e onkologjisë.
  - Mbyllin një shtëpi.
  - Të parat në stafetë.
  - Qe profet i vogël.
  - Me break në tenis.
  - Mbyllin një sirtar.
  - Qe perëndesha që lindi Arionin.
- VERTIKAL**
- Inicialet e Santana-s, kitarist.
  - Nota e diapazonit.
  - Eshhtë frika nga shehet e hapura.
  - Diftong në duar.
  - Duhen në ekstreme.
  - Qe libri erotik i Mallanaga Yatsuyana-s.
  - Lauda ish-pilot i Formula 1.

- Janë lotët që gjithkush i derdh me kënaqësi.
- Një poemë.
- Fund tuneli.
- Një eleganat si Aramis.
- Qe kryeqyteti i Asirisë.
- Qe tereador i famshëm.
- Urdhëroi sakrifikimin e Ifigjenias.
- Eshhtë pushteti i... bashkisë.
- Qe lumi i Karontit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Ishte giuha e Jezu Krishtit.
- U shndërrua në dre nga Afërdita.
- Rex i Nero Wolfe.
- Nino, kompozitor i njohur.
- Një... story e John Le Carrë.
- Shkroi Tregime të jshhtëzakonshme.
- Kufizojnë një sektor.
- Inicialet e Einstein.
- Inicialet e Matthieu, këngëtare.
- Kufizojnë sportet.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Lindi Isakun.
- Në krye të bashkisë.
- Në djep kur nuk... je.
- Nota e diapazonit.
- Emri i parë i Erasmit të Rotterdemit.
- Mbyllin akte.
- Filozofi i famshëm me historine e gomarit.
- Diku në qendër.
- Rrallë është përgjysmë.
- Bëri edhe Madame Butterfly.
- Norman, psikopati te Psycho.
- Të parat në sjellje.
- Vret me një re.
- Gjarpi që u vra nga Apolloni.
- Lindi Perseun.
- Besniku mesfushor.
- Ai i vajimit është në Jerusalem.
- Carol, aktore.
- Në krye të subjekteve.

**VERTIKAL**


- Ishte sundimtari i provincave perseisha.
- Inicialet e Duvall.
- Qyte i njembjndëritarve.
- Ishin armiqetëe babilonasve.
- Shkroi Jacuques le fataliste.
- Eshhtë edhe tendencë.
- Joan i interpretuar nga Celentano.
- Jetojnë në vetmi.
- U soll në Europë në Jean Nicot.
- Ai i Aida-s është Radames.
- Një ishte edhe Deceballi.
- Inicialet e Rohmer regjisor.
- Titulli i Bruce Springsteen.
- Hidhet një me... kërcim.
- U shkrua nga Camus.
- Fillojnë takimin.
- Fillojnë natën.
- Pierce teniste.
- Grisur pa gur.
- Fillojnë panikun.
- Shijuar pa shuar.
- Fleming, që krijoi James Bond.
- Kështu merr ai që... mbaron.
- Mbajtësja e topit në golf.
- Ekstreme për gotik.
- Carson i fumnetit-t.
- Një padi kur s'është ai.
- Bëhen arianë me një anë.
- Harris që krijoi Hannibal Lecter (inic).
- Bëhet nuse me ne.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

			4					3
			6					2
			8	1			5	
6				7			4	
	1		3					
		9		5				
				3				5
	3	9	2	5			7	4
	6		7	4				8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	3	2	8	1	5	9	4	6
5	4	9	7	6	3	8	2	1
8	6	1	4	2	9	3	5	7
4	5	6	3	8	1	7	9	2
2	7	8	5	9	6	1	3	4
9	1	3	2	4	7	5	6	8
3	8	4	9	7	2	6	1	5
6	9	7	1	5	4	2	8	3
1	2	5	6	3	8	4	7	9

*Argëtim filozofik*

- Nuk me vjen inat që më gënjën, por më vjen inatë përse mendoni që besoj në ju.
- Më mirë është të meritosh e mos të fitosh, sesa të fitosh e të mos meritosh.
- Asnjëherë mos debato me një budalla. Një tjetër që mund të jetë duke shikuar, nuk do të dijë të bëjë diferencën.
- Një skllav ëndron lirinë, një njeri i lirë ëndëron pasurinë, një i pasur ëndëron fuqinë dhe një fuqishëm ëndëron lirinë...

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	K	A	12	F	3	E		2	1	6	3	10	2
1	9	1	8				11	1	12		2	3	7
3	2	2			13	3	11	1	2	4	2	4	
3	2			13	3	7	3	2	4	5	3		
15		5	9	8	4	2	3	2	3	2			
9		3	5	4	11	5	2		2		12		
7	4	5			10	3	2		2	1	11	1	
4		9			15	16			17	2	4	6	
5	1	17	20	4	10	15				17	6		
3	9		11	1	2	3	10	2	1	2			
	10	1			19	3			18	7	1	2	
1	19	8	4				11	4	7	1	2	4	

S	T	R	I	P	B	B	V	O	T	A		
H	E	R	O	I	N	A	O	V	E	R		
S	A	S	S	N	R	V	R	E	R	O	R	E
U	T	S	H	T	E	T	E	R	O	R	E	
B	L	I	T	E	R	A	T	U	R	A	T	
M	I	N	E	R	A	L	E	T	C			
K	A	L	O	R	E	S	I	T	H	A	V	
C	A	R	I	S	T	I	N	T	L			
V	H	I	M	I	M	I	K	L				
R	A	M	E	T	N	A	A	R	R			
A	D	R	E	S	E	I	T	A	L	I	A	
P	O	L	E	M	I	K	A	S	E	A	T	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË KALUAR**

M	A	T	A	H	E	L	M	E	T			
A	R	R	A	V	E	D	D	E	P	P	A	
P	A	R	A	L	E	L	E	T	L	E	R	
P	G	L	I	F	E	M	I	O	L	E		
E	M	I	L	E	Z	O	L	A	R	T	I	K
L	A	I	R	A	E	R	R	E	Z	E		
E	R	A	I	B	E	M	R	I	S			
H	I	M	A	E	S	T	R	O	D	E		
T	A	L	E	N	T	E	T	A	R	E		
E	K	R	A	H	G	R	A	R	I	A		
S	I	P	R	I	T	A	T	A				
K	A	P	A	N	O	N	E	T	L	A	L	A
D	I	S	K	O	T	E	K	A	T	A	P	
R	O	M	A	N	A	R	G	O	S	A		
E	N	T	C	N	I	R	H	R				
W	M	O	N	O	G	R	A	F	I	A		
P	E	L	E	G	R	I	N	A	Z	H	E	T
P	O	L	I	G	L	O	T	E	T	I	D	E
A	L	K	R	A	H	E	T	K	S	H		
K	E	N	I	T	K	A	M	E	T			
E	M	I	L	E	S	N	J	O	M	E	R	
T	I	M	E	R	S	T	A	N	E	T	I	
A	K	S	E	R	I	O	Z	A	M			
T	E	O	T	R	A	Z	J	A	R	R	I	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Thënie të mençura*

- Nuk ka trëndafila pa gjemba, por ka gjemba pa trëndafila.
- Arthur Schopenhauer
- Nëse nuk tregon të vërteten për veten
- nuk mund të tregosh dot as për të tjerët.
- Kush jeton sipas të gjitha rregullave
- humb gjithë kënaqësitë.
- Qmenduri është të bësh gjithmonë të njëjtën gjë
- dhe të presësh rezultate të ndryshme.

